UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo

UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration Intérimaire
des Nations Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPT

NGA MBLEDHJA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 31 TETOR 2002

TRANSKRIPT

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 31. OKTOBRA 2002

Nëntor - Novembar
2002

Verzioni angleze me mbizotru
Engleska verzija
preovladava
English version prevails

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo

UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

Projekt rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Procesverbali nga mbledhja e kaluar

3.1 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Telekomunikacion (2002/7)
3.2 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Mbrojtjen e Ambientit (2002/8)
3.3 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Aktivitetet e Tregtisë me Jashtë (2002/6) (të konfirmohet)

4. Parashtrimi i pyetjeve

Vrejtje : *Pyetjet për Qeverinë për përgjigjet me gojë*

"Pyetjet për përgjigjet me gojë duhet ti dorzohen Zyrës për parashtresa të paktën pesë ditë pune por jo më shumë se dhjetë ditë pune para kohës kur duhet përgjigjur në to ".
(Rregulla 19.2 nga Rregullorja e përkohshme e punës)

ДНЕВНИ РЕД

Пројект дневног реда:

1. Усвајање дневног реда
2. Записник са претходне седнице

3.1 Прво разматрање Нацрта закона о Телекомуникацијама (2002/7)
3.2 Прво разматрање Нацрта Закона о Заштити Средине (2002/8)
3.3 Друго разматрање Нацрта закона о Активностима Цпољне Трговине(2002/6) (потврдити)

4. Постављање питања

Опомена : *Питања упучена Влади за усмене одговоре*

"Питања која захтевају усмени одговор морају да буду достављена у пријемну канцеларију рем пет радних дана, али не више од десет радних дана пре него што се очекује одговор"
(Правило 19.2 са Привремени пословник)

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo

UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration Intérimaire
des Nations Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPT
MGA MBLEDHJA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 31. TETOR 2002.

Mbledhja filloi punën në orën 10,00.

Mbledhjen plenare e kryesoi akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes, mirë se keni ardhur në seancën plenare. I shpalli të hapura punimet e seancës së sotme plenare. Shpresoj se përkthimi është në rregull dhe telefonat celularë të gjithë do t'i çkyçim e edhe unë e kam të çkyçur timin. Shpresoj se rendin e ditës dhe materialet përcjellëse i kanë marrë deputetët me kohë nga posta e tyre në parlament dhe në qoftë se ka ndokush diçka lidhur me rendin e ditës. E ka fjalën zoti Fatmir Limaj, Partia Demokratike e Kosovës.

FATMIR LIMAJ:

Të falemnderit zoti kryetar. Të nderuar kolegë deputetë. Pas një fushate të kulturuar dhe demokratike që kanë zhvilluar subjektet politike në Kosovë, qytetarët dhe simpatizantët e

partive të ndryshme politike, pas një pune të palodhshme jashtëzakonisht të mirë që bënë mekanizmat të cilat i përcollën, i përgatitën dhe i udhëhoqën në procesin zgjedhor, pas rezultateve zgjedhore ku për asnjërën parti politike dhe ne të paktën si grup parlamentar i Partisë Demokratike mendojmë nuk ka qenë i diskutueshëm rezultati zgjedhor, ndodhi një ngjarje tragjike ku me një rast aksidental tragjik humbi jetën kryetari i Komunës së Suharekës, zoti Ukë Bytyqi, përmes së cilës, ne si grup parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ngushllojmë familjen e tij dhe Asamblenë Komunale në Therandë dhe pas gjithë kësaj, sikur u prish e gjithë ajo klimë demokratike që ishte zhvilluar në gjithë procesin zgjedhor, mund të them lirisht u prish klima e marrëdhënieve ndërqytetare për të cilën kemi investuar për dy vjetët e fundit, fatkeqësisht ky rast tragjik u politizua dhe keqpërdor në masën jo të drejtë që më së shumti e dëmtoi qytetarin e Kosovës dhe po e dëmton sot. Rasti tragjik i ndodhur në ditën, në mesin e 300 ose 500 dëshmitarëve, po politizohet në masën i cili po e dëmton vetë qytetarin e Kosovës. Ne shprehim keqardhjen tonë për politizim të panevojshëm që i bëhet rastit të vrasjes së kryetarit të Komunës zotit Ukë Bytyqi. Raste të tilla tragjike ndodhin çdokund, rasti kriminal duhet të dënohet, personi i cili ka bërë veprën e tillë dihet me emër e mbiemër, organet gjyqësore-policore janë ata të cilët duhet të mirren me këtë rast. Dhe, përderisa të dihet aktori, dihet mënyra, forma se si është bërë vepra është mirë që ne si deputetë, si institucione t'i rrespektojmë organet tona ligjore dhe njëkohësisht nga ky vend t'i çojmë mesazhet për qetësimin e qytetarëve dhe jo ta politizojmë rastin e tillë. Mendoj që deklaratat e fundit pas rastit të vrasjes së kryetarit të komunës më tepër kanë ndihmuar në prishjen e klimës ndërqytetare, kanë shtyrë në hasmimin e qytetarëve. Keqpërdorimi i institucionit i cili është përdorur me këtë rast më së shumti e kanë dëmtuar qytetarin e Kosovës. Prandaj, në emër të grupit parlamentar të Kosovës, shprehim protestën tonë për formën dhe mënyrën e qasjes institucionale ndaj këtij rasti. Në vend që të mblidhemi ne si institucione, si subjekte, si deputetë dhe të gjithë ta dënojmë këtë rast dhe të gjithë ta mbështesim ose t'i gjendemi asaj familje në rastin tragjik, këtu dikush për qëllime politike dëshiron që një rast të tillë ta politizojë sa që edhe ta quajë si terror apo se di çka tjetër. Prandaj, ju ftoj përsëri, në emër të grupit parlamentar, të gjithë deputetët që me këtë rast dhe raste të tilla të jemi në nivel të

institucionit, të detyrave dhe të mos dalim para organeve gjyqësore, para policisë e të japim deklarata dhe vlerësime të cilat më së shumti i dëmtojnë vetë qytetarët e Kosovës, dëmtojnë edhe vetë klimën demokratike dhe institucionet demokratike të cilat po i ndërtojmë.

KRYESUESI:

Ju lutem, do ta kemi fjalën të gjithë. Urdhëroni. E ka fjalën, ju i fundit, i Leposaviqit.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Poštovani predsedniče, dame i gospodo poslanici, ja imam primedbu na predloženi dnevni red i predlažem da se tačka dnevnog reda Razmatranje Zakona o spoljnoj trgovini, odnosno čitanje Zakona o spoljnoj trgovini skine sa dnevnog reda iz sledećih razloga: Komisija za prava interesa zajednica nije razmatrala Nacrt ovoga zakona što je inače po odredbi člana 9.1.35. Ustavnog okvira i Pravila 29. Privremenog poslovnika Skupštine trebalo da čini. Komisija za prava i interese zajednica se nije sastajala izmedju zasedanja na kojemu je Zakon o spoljnoj trgovini predstavljen i ovog zasedanja o čemu je Predsedništvo Skupštine informisano pismenim putem. Naime, Komisija za prava i interese zajednica je trebalo da ima dve sednice izmedju ova dva zasedanja, dakle izmedju zasedanja na kojemu je Zakon predstavljen i današnjeg zasedanja ali nažalost nijedna sednica is prostog razloga što na te sednice nije došla ogromna većina članova ove Komisije. Na prvoj sednici je bilo svega tri, zapravo prvoga dana kada je trebalo da bude sednica, a drugoga dana kada je zakazana sednica bilo je samo dva člana ove komisije od ukupno 14. Mi smo Predsedništvo Skupštine o tome obavestili. Ne znam da li je Predsedništvo dobilo to obaveštenje i da li je reagovala ali nešto mora da se učini, da se stvore bolji uslovi i bolje pretpostavke za ovaj rad ove komisije koja je inače vrlo važna Skupštinska komisija. Zbog toga sam mišljenja da nisu se ispunili pretpostavke iz člana 9.1.36 i 9.1.37. Ustavnog okvira i Pravila 30. Privremenog poslovnika Skupštine za razmatranje prispelih amandmana kojih je bilo od strane drugih komisija odnosno za drugo čitanje ovog zakona. Ne vidim, zaista ne vidim mogućnost da se bilo koji zakon pa

ni ovaj ako nije bio razmotren od strane Komisije za prava i interese zajednica može dati na drugo čitanje. Hvala lepo.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Z. Kolë Berisha e ka fjalën.

KOLË BERISHA:

I nderuari kryetar, të nderuar kolegë. Ukë Bytyqi dikur ishte anëtar i këtij Parlamenti, respektivisht ishte në Parlament atëherë kur duhej t'i thuhej "Jo" Serbisë. Prandaj, mendoj se sot punimet e kësaj seance duhet të fillojë me një minutë heshtje për nderimin e tij. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Unë do të doja përkrahjen unike të përbërjes së plotë të Parlamentit në këtë. Vlerësimet për humbjen tragjike për një njeri të devotshëm në luftën për liri, demokraci dhe pavarësi të Kosovës janë dhënë në një mënyrë të shkruar nga kryetari i Kosovës, nga kryeministri i Qeverisë së Kosovës dhe, deputetë të nderuar, nga kryetari i Parlamentit të Kosovës. Dhe, jashtë asaj, do të ishte e pahijshme që të themi diçka, por më lejoni që vërtetë për shkak të participimit një kohë të gjatë në luftë për liri të Kosovës, të pjesëmarrjes aktive si deputet i shumëhershëm i Parlamentit të Kosovës të ju ftoj që me një minutë heshtje t'ia bëjmë nderimet e fundit.

(BËHET HESHTJE NJËMINUTËSHE)

KRYESUESI:

LAVDI!

Sa i përket rendit të ditës, edhe Kryesia e Parlamentit në një takim ad hoc, konsultativ do të thotë jo formal, është e mendimit që shqyrtimi i dytë i Ligjit për tregti me jashtë kësaj radhe të heqet nga rendi i ditës për një arsye të vetme procedurale sepse komisionet përgjegjëse për shqyrtimin e këtij ligji nuk kanë kryer, nuk kanë arritur ma mirë të them, ta kryejnë punën e vet konform Kornizës kushtetuese dhe Rregullores në fuqi. Disa herë, mos t'i përsërisim, edhe publikisht janë thënë arsyet e mosmundësisë së ushtrimit të detyrës së deputetit në një normë cilësore sikur e kërkon aktualtiteti kosovar dhe një parlament serioz. Ka qenë edhe lutja e fundit e grupeve parlamentare që të bisedojnë me anëtarët e vet në komisionet përkatëse që maksimalisht të bëjnë përpjekje deputetët edhe përkundër të gjitha vështirësive që t'i kryejmë obligimet tona, ndërsa Kryesia e Parlamentit të Kosovës të ngelë pranë vendimit të vet të marrur diku në korrik dhe po bëjmë çmos të gjithë në një mundësi që t'i avancojmë kushtet e punës në Parlament. Prandaj, mendoj se kjo pikë e rendit të ditës do të shqyrtohet në një seancë tjetër të radhës dhe besoj në të parën më 7 nëntor. Prandaj, rreth rendit të ditës nuk do të doja të kemi ndonjë debat tjetër. Në qoftë se keni për rend të ditës, zoti Nojkiq, nuk do të doja... Urdhëroni...

GANI PREKOPUCA:

Zonja dhe zotërinjë, Kryesi e nderuar. Unë nuk do të flas rreth rendit të ditës, por po më duket e palogjikshme që të kalohet, të anashkalohet pika të cilën e bëmë me një minutë heshtje. Unë dua me pyet këtë Parlament dhe juve zotërinjë Kryesi – cili është në radhë prej neve, cili do të shkojë dhe më vonë do të themi atë se ka ndodhur një aksident?! Ju lutem krejt bota e pa se është krimi politik. Është vrarë kreytari i komunës. Kryeministri thotë: mos e bëni të madhe. Dalin napër televizion njerëzit, thonë – s'ka ndodhur asgjë. Deri kur Parlamenti do të shukatë dhe nuk do të kërkojë nga shërbimi i cili është përgjegjës për sigurinë e qytetarëve të Kosovës. Edhe sa kryetarë komune duhet të vriten dhe neve dikush këtu të na jepë informatën se kush e ka bërë. Edhe një herë po them – deri kurë do të ndodhë kjo? Kaq pata.

KRYESUESI:

Ju lutem zoti Geci, ju lutem zoti profesor. Më lejoni një herë të jam i qetë. Për askë nuk është lehtë në Kosovë. Ne jemi marrë vesh bashkërisht njëzërit këtu që një ditë në rend të ditës si temë kryesore boshte e seancës plenare të jetë çështja e sigurisë në Kosovë dhe çështja e ushtrimit të pushtetit të institucioneve legale në tërë territorin e Kosovës. Prandaj, mosni në këto momente jo të lehta për Kosovën. Parlamenti duhet të jetë institucion i cili do të ndikojë vërtetë në zbardhjen e çdo të keqeje por edhe në uljen e tensioneve, në krijimin e një klime konstruktive për punë në mënyrë që Kosovës do t'i bijmë ligje me të cilat do të mënjanohen të gjitha të këqiat. Prandaj, nuk i ikim asaj që Kryesia ta vëjë në rendin e ditës çështjen e sigurisë, sot kemi rendin e ditës dhe ju lus që të shkojmë sipas rendit të ditës që e ka aprovuar Kryesia. Urdhëro... Nojkiq.

RANDJEL NOJKIĆ:

Gospodine predsedavajući, dame i gospodo. Na osnovu pravila 17 tačke 2. Pravilnika o radu ove Skupštine i pravila 23. predlažem da se tačka 3.1. Nacrt zakona o telekomunikacijama povuče iz današnje procedure. A evo iz kojih razloga. Verovatno ste svi dobili, kao što sam i ja dobio, primedbe koje je iz kancelarije SPGS-a pravni savetnik dostavio članovima Skupštine na Nacrt ovog zakona. Primedbe su veoma ozbiljne. Primedbe se tiču rezervisanog prava SPGS-a. Zatim, ja sam primetio nešto što mi malo nije baš logično a to je da na engleskom jeziku ima 56 primedaba a na albanskom i na srpskom 43. Znači da nešto nije u redu. Pokušao sam da na jedan korektan način upišem sve primedbe u ovaj nacrt zakona i došao sam do mnoge nelogičnosti, video sam zapravo primedbe koje su date na srpskom ne mogu da se uklope u onim primedbama koje su date od strane SPGS-a, odnosno savetnika SPGS-a. To samo po sebi govori da verovatno sve ove varijante, tri varijante, znači srpska-albanska-engleska nisu usaglašene i moj drugi razlog zašto tražim da se povuče to jeste - mislim da ubuduće trebalo neko iz Skupštine, verovatno jezička grupa, jezičko odeljenje ili neko drugi koji je već ovlašćen da pre nego se daju zakoni, nacrti zakona na razmatranje da mora da se daju nekakve garancije da su sve tri verzije identične. Mi smo već imali više puta primere ovde da verzije nisu bile

usaglašene i onda smo imali dodatne probleme. Mislim da bi to trebalo da se izbegne u samom startu. Zatim, treći takodje veoma veliki razlog po meni jeste zato što ovaj zakon može da bude, može da bude kažem diskriminirajući iz sledećih razloga. Mi imamo više desetine hiljada...

KRYESUESI:

Ju lutem pa diskutime politike. Ju lutem rendin e ditës e patëm, keni të drejtë me e kundërshtue, prandaj ju ka kalue koha. Mjaft është, ju ka skaduar koha, përkthimi le të funksionojë, e thatë ju atë. Ju ka kaluar koha për debat. E thatë atë, do ta shqyrtojmë propozimin...E ka fjalën Bajrush Xhemajli, i fundit dhe do të votojmë për rendin e ditës, ju lutem.

BAJRUSH XHEMAJLI:

E nderuara Kryesi, të nderuar kolegë deputetë. Sa i përket rendit të ditës, u tha se nuk është kryer puna në komisione. Ne, Komisioni për tregti dhe industri e kemi kryer punën me kohë menjëherë pas shqyrtimit të parë, pas tri-katër ditësh. Ka pasur kohë të mjaftueshme për t'u shqyrtuar edhe nga komisionet tjera. Pavarësisht a do të votohet për këtë që të jetë në rend të ditës Projektligji për tregti dhe industri, unë mendoj e meritojmë një sqarim se kush kreu dhe kush s'kreu punë. Le të dihet së paku. Janë edhe dy komisione permanente, nëse e kanë krye ta dijmë se e kanë kryer. Ne për veti e kemi krye. Dhe, mendoj që gjithëherë kur të hiqet prej rendit të ditës, nëse hiqet, ta dijmë se për çka.
Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Nuk po mund t'i çkyçemi logjikës që patjetër duhet ta emërtojmë fajtorin në parlament. Unë thash – komisionet. Nuk desha të identifikojë dhe për këtë Kryesia është e informuar. Duhet tre komisione ta kenë përfunduar punën për këtë. Komisioni

juaj e ka kryer menjëherë në kohë i pari, por unë nuk po dua me shkue në atë. Dy komisionet tjera nuk e kanë kryer punën, prandaj ju lutem propozoj që rendi i ditës të vëhet në votim, duke e hequr Shqyrtimin e dytë të Ligjit për tregti me jashtë.

Kush është për, ju lutem le ta çojë dorën? Numëroni votat ju lutem.
Kush është kundër?
Kush abstenon nga votimi, ju lutem. (Ju lutem përkthimi le të jetë në rregull).

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For.....83
Kundër – Protiv – Against.....14
Abstenuan – Uzdržanih – Abstaned..... 01

Pika e ardhshme e rendit Procesverbali i mbledhjes dhe skripti. Një informatë. Deputetët e kanë marrë skriptin ashtu siç është me anën fonike në gjuhën që ka diskutuar deputeti sepse mënyrë tjetër nuk ka dhe procesverbali. Në qoftë se ndokush ka ndonjë vërejtje të rëndësishme që e ndërron natyrën e propozimit apo të diskutimit të tijë le ta thotë, le ta shkruaj dhe le të përmirësohet. Dhe, pyes a ka kush ndonjë vërejtje? Ju falemnderit.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës – **SHQYRTIMI I PARË I LIGJIT PËR TELEKOMUNIKIM.**

Lus ministrin, zotin Zef Morina, që të japë fjalën hyrëse për këtë ligj.

ZEF MORINA:

I nderuari zoti kryetar, e nderuara Kryesi, deputetë të nderuar, lolegë ministra.

Ligji i propozuar për telekomunikacion është prioritet kryesor për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit, është përgjigje për nevojën urgjente, për një lilgj gjithpërfshirës dhe bashkëkohor në sektorin e telekomunikacionit, i cili, si i tillë, është

identifikuar në mesin e prioriteteve më të larta të Qeverisë, në Programin e saj ekonomik, i cili qe publikuar në mars të këtij viti. Ligji përfaqëson një hap të rëndësishëm në krijimin e strukturave demokratike në Kosovë sepse i sqaron përgjegjësitë dhe kompetencat e entiteteve përgjegjëse për sektorin e telekomunikacionit ashtu siç është përcaktuar me Kornizën kushtetuese. Derisa disa aspekte teknike në këtë sektor mbesin akoma funksion i rezervuar për PSSP-ën, përgjegjësia më e madhe për zhvillimin e përgjithshëm të sektorit i takon Qeverisë. Pas disa dekadave të neglizhencës do të ishte gabim që reformat në këtë sektor të vonoheshin qoftë edhe për një ditë të vetme. Ligji rritë transparencën dhe efikasitetin e sektorit telekomunikativ nëpërmes të krijimit të rregullatorit të pavarur, utoritet rregullativ në telekomunikacion i cili si i tillë i raporton në mënyrë direkte Kuvendit. ART-ja do të bëjë implementimin e politikave të qeverisë duke u bazuar në procedurat transparente të paraqitura në Ligj, i cili ofron tretman të barabartë për ofruesit e shërbimeve dhe kushte jodiskriminuese për të gjithë shfrytëzuesit. Ly ligj, duke krijuar një kornizë rregullative ligjore, e cila është plotësisht në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare, i jep shtytje zhvillimit ekonomik dhe bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar dhe bën hapjen e tregut të konkurencës dhe të investimeve të huaja. Investimet e mëdha janë të nevojshme për të arritur nivelet e mbulimit me telefoni siç janë në vendet tjera të Evropës dhe kjo mund të arrihet vetëm me një kornizë rregullative e cila nxitë pjesëmarrjen e sektorit privat. Është veçmas me rëndësi që t'u ofrohet shërbime atyre që jetojnë në vende rurale dhe atyre hapësirave të cilat nuk janë të mbuluara me këto shërbime.

Ky ligj do të rrisë punësimin nëpërmes të krijimit të mundësisë që autoriteti i rregullatorit të komunikacionit nëpërmes të një tenderi ndërkombëtar të liçencojë së paku dy ofrues të tjerë të shërbimeve; do të ketë një liçencë shtesë për telefoninë mobile GSM dhe së paku një koncesioner për telefoninë fikse. Ajo që del nga këto ankande është përfitimi i menjëhershëm për Buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe atëherë kur ofruesit e

shërbimeve të fillojnë me aktivitetin do të fillojë me një kontribut mjaft domethënës në të ardhurat e Buxhetit të konsoliduar të Kosovës përmes mbledhjes së TVSH-ës.

Ligji parasheh një kohë të afatizuar të veçantë sepse deri më tash veç është humbur më shumë se një dekadë. Autoriteti rregullator i telekomunikacionit do të jetë entitet vetëfinancues pas një periudhe fillestare të shkurtër të kufizuar dhe do të ketë ndikim të vogël në Buxhetin e konsoliduar të Kosovës. ART-ja do të bëjë mbledhjen e pagesave administrative nga ofruesit e shërbimeve. Në përputhje me standardet e Unionit Evropian do të ketë një numër të pakufizuar liçencash për ofruesit e shërbimeve telekomunikuese me kusht që numrat dhe burimet spektrale të mundësojnë këtë gjë.

Po japim përgjithësimet e secilit nen të rëndësishëm.

Nga neni 1 deri 3 – Qëllimet, definicionet dhe kompetencat.
Neni 4 deri 15 – themelimi i autoritetit rregullativ në telekomunikacion. Rregullatori duhet të themelohet si një trup i pavarur i vetëfinancuar nëpërmes pagesave administrative, liçencave, caktimeve të frekuencave, numrave e tjerë. Autoriteti ligjor rregullativ shprehet përmes bordit të tijë i cili duhet të përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë dhe jo më shumë se 7 dhe t'i raportojë në mënyrë direkte Kuvendit.

Neni 16 deri 17: Hyrja në treg dhe përshtatja me standardet e Unionit Evropian. Teknologjia dhe aplikimet ndryshojnë në mënyrë të shpejtë. Ligji përfshin mekanizmat për të nxitur shfrytëzimin e shërbimeve më bashkëkohore dhe përshtatjen e praktikave më të mira në zhvillimin e sektorit.

Nga neni 18 deri 25: Autorizimet dhe liçencat. Të gjitha shërbimet telekomunikuese që i ofrohen publikut duhet të marrin autorizimin e rregullatorit. Të gjithë operatorët e shërbimeve telefonike duhet të ofrojnë qasje në numeratorët telefonikë dhe thirrje falas për shërbimet emergjente, përfshirë rastet e zjarrit, policinë, ambulancën. Të gjithë operatorët që ofrojnë infrastrukturën e tyre për konsumatorët qoftë ata me tela apo pa tela

duhet të jenë të liçencuar nga autoriteti rregullator i telekomunikacionit. Numri i liçencave që mund të lëshojë autoriteti i rregullatorit të telekomuinikacionit është i pakufizuar përveç nëse kjo varet nga burimet spektrale të kufizuara.

Numrimi apo kapaciteti i kablit. Të gjithë ofruesit e shërbimeve duhet të kenë të njëjtat obligime, përfshirë qasjen jodiskriminuese, hapjen e rrjetit për ndërlidhje dhe çmimet e bazuara në shpenzime. Ofruesit e shërbimeve duhet të ndërmarrin një kontroll të pavarur financiar dhe të përputhen me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. Asnjë ofrues i shërbimeve me një fuqi domethënëse në treg që ka më shumë se 25% të aksioneve, në aktivitet komercial të të njëjtit lloj nuk ka të drejtë privilegjeje në shërbimet e ndryshme telekomunikuese. Autoriteti i rregullatorit të telekomunikacionit do të mbledhë pagesa administrative për lëshimin e autorizimeve, liçencimin dhe alokimin e frekuencave dhe numrave.

Nga neni 26 deri 37. Radioferekuencat dhe plani numerativ për shërbimet telekomunikuese. Menaxhimi frekuencor sipas Kornizës kushtetuese është kompetencë e rezervuar për PSSP-ën, mirëpo disa funksione administrative do të kryhen nga autoriteti rregullator i telekomunikacionit. ART-ja do të caktojë frekuencat për shfrytëzuesit e vegjël. ART-ja duhet që të përgatisë planin numerativ, caktimin e numrave apo grupit të numrave për operatorët dhe të administrojë me to në mënyrë jodiskriminuese. Për të kryer këto shërbime ART-ja do të mbledhë pagesa administrative nga ofruesit e shërbimeve.

Neni 38 deri 46. Ofruesit e shërbimeve. Ligji krijon kushte bazike për ofrimin e shërbimeve telefonike për publikin, përfshirë kualitetin e lartë të shërbimeve dhe çmimet jodiskriminuese. Gjithashtu kërkon që gjithë ofruesit e shërbimeve të ndërlidhin rrjetat e tyre publike.

Neni 47 deri 49. Shërbimet universale. Autoriteti i rregullatorit do të ofrojë shërbimet telekomunikuese për publikun pa marrë parasysh distancën e tyre gjeografike dhe gjendjen financiare. ART-ja do të krijojë një tender konkurues ndërkombëtar i cili do të

ofrojë mbi 150.000 linja për konsumatorët nëpër tërë territorin e Kosovës. ART-ja duhet të lëshojë një tender ndërkombëtar konkurues për lidhje me "fi-optike"për rrjetin regjional.

Nga neni 50 deri 55. Rrjeti telekomunikues dhe shërbimet. Ligji bën përshtatjen e parimeve bazike të kornizës ligjore rregullative të Unionit Evropian për sektorin e telekomunikacionit për funksionimin e ndërsjellt dhe shërbimeve të avancuara.

Nga neni 56 deri në nenin 60. Pajisjet telekomunikuese. Të gjitha pajisjet radio dhe terminale që gjenden në treg, shiten, shfrytëzohen apo prodhohen në Kosovë duhet të jenë konform standardeve të përshtatura nga ART për të mbrojtur shëndetin publik dhe sigurinë dhe gjithashtu për t'i shmangur interferencat radio dhe elektro-magnetike.

Pajisjet të cilat janë në përputhshmëri me standardet e aplikueshme të krijuara nga institucioni evropian i standardeve telekomuinikuese duhet të merren si të pranueshme për Kosovën.

Nga neni 67 deri 76. Mbrojtja e konsumatorit dhe fshehtësitë. Të gjithë personat duhet të kenë të drejtë të shfrytzojnë shërbimet publike telefonike në tërë territorin e Kosovës duke u bazuar në të njëjtat kushte dhe në çmimet e publikuara. Të gjithë shfrytëzuesit kanë të drejtë të ankohen tek autoriteti rregullativ i telekomunikacionit nëse ofruesi i shërbimeve dështon t'i përmbahet obligimeve dhe të pranojë arbitrazhin që ta zgjidhë kontestin. Me kërkesën e konsumatorëve ata mund ta marrin gjendjen e fakturës për shërbime që ata i kanë shfrytëzuar. Ofruesit e shërbimeve duhet të publikojnë detajet e kushteve të tyre të përgjithshme që kanë të bëjnë me masat e ndërmarra dhe procedurat që duhet të aplikohen në rast se nuk paguhen faturat e shërbimeve. Të gjithë ofruesit e shërbimeve duhet ta mbrojnë fshehtësinë telekomunikuese, përfshirë konsumatorin apo informatat lidhur me faturat telefonike. Bazuar në rregullat në aplikimin për procedurat kriminale apo për sigurinë kombëtare nëse kërkohet ofruesi i shërbimit mund të ofrojë qasje në rrjetin e tij për autoritetin e caktuar për përgjimin, gjurmimin e thirrjeve e thirrjeve apo informacionin për numrat e thirrur nga konsumatori. Ofruesit e shërbimeve

duhetg të krijojnë kushte për qasje publike për disa informacione për konsumatorin përfshirë numrat telefonikë dhe dhënien e numrave telefonikë.

Neni 77. Dispozita përfundimtare. Ligji është në pajtim me Kornizën kushtetuese. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Zoti ministër, ju falemnderit. Ju informoj se deputetët me kohë e kanë marrë këtë projektligj. Sot është debati vetëm si shqyrtim në parim. Edita Tahiri e ka fjalën.

EDITA TAHIRI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë dhe ministra. Bërja e Kosovës me Ligjin e telekomunikacionit paraqet njërin nga hapat shumë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe demokratik të Kosovës. Siç është parë, në periudhën e paslufës sektori i telekomunikacionit është bërë njëri nga shtyllat kryesore të ekonomisë së Kosovës. Në një gjendje fare të brishtë në të cilën gjendet sot ekonomia e Kosovës, zhvillimi i drejtë dhe modernizimi i fushës së telekomunikacionit është me interes vital për Kosovën. Andaj, shqyrtimi i drejtë i këtij projektligji dhe më pas edhe miratimi i tij nga ana e Kuvendit të Kosovës janë të një rëndësie substanciale. Në bazë të shqyrtimit që unë i kam bërë këtij projektligji për telekomunikacion, mund të them se në parim kjo është një kornizë adekuate ligjore e cila krijon mundësitë e një zhvillimi të një telekomunikacioni modern në Kosovë si dhe është kompatabil me kriteret ndërkombëtare. Ky projektligj ndjek konceptin e liberalizimit të tregut të telekomunikacionit që është në përputhje me synimet e Kosovës për reformat ekonomike dhe demokratike si dhe i përgjigjet kritereve të Organizatës botërore për tregti dhe të Unionit Evropian

Duke marrë parasysh monopolin që sot mbizotëron në Telekomunikacionin e Kosovës i cili po shoqërohet me shërbimet e cilësisë jo të mirë, me çmime të shtrenjta dhe me qasje të pamjaftueshme liberalizimi do të krijojë perspektiva për konkurencën lojale dhe

privatizimin në veprimtarinë telekomunikuese duke përmbushur në mënyrë të volitshme kërkesat dhe interesat e qytetarëve të Kosovës. Ky projektligj do t'i japë fund kaosit në tregun e Telekomunikacionit të Kosovës që është pasojë e veprimit ilegal të disa operatorëve të telefonisë mobile siç janë Mobteli, Mabimaku e tjerë. Po ashtu, me këtë projektligj do të pushojë aneksimi i një pjese të rrjetit të PTK-ës nga ana e Telekomit të Serbisë. Pra, siç e dini, fjala është rrjetin telefonik në pjesën veriore të Mitrovicës dhe nëpër enklava siç janë Graçanicë, Shtërpcë, Prilluzhë e tjerë.

Mirëpo, synimet e lartpërmendura nuk mund të realizohen në tërësi pa disa ndryshime dhe plotësime që duhet të bëhen në këtë projektligj. Për shembull, neni 34 duhet të ndryshojë sepse, me formulimin që ka tani, ai paragjykon operatorët që do të licencohen. Më sakt, neni 34 legalizon automatikisht veprimin e Mobtelit dhe Mobimakut.. Kjo nuk është qasje e drejtë dhe si e tillë është e papranueshme. Në fakt, përmbajtja e nenit 34 duhet të jetë e tillë që të krijojë kushte normale dhe të barabarta për të gjithë konkurentët potencialë për operatorë të telefonisë mobile. Ky nen duhet të mbështetet mbi dy parime kryesore:

1. Në parimin e konkurencës lojale, dhe
2. Në parimin që konkurenti i licencuar të sjellë një teknologji më të avancuar se ajo që ekziston sot në Kosovë.

Ka vend edhe për vërejtje të tjera, por ato do të paraqiten në mënyrë të përmbledhur në shqyrtimin tjetër.

Sa i përket kompetencave të Ministrisë për Transport dhe Telekomunikacion dhe të vetë Qeverisë së Kosovës në fushën e telekomunikacionit në relacion me kompetencat e PS të Sekretarit gjeneral dhe të UNMIK-ut, mendoj se ka nevojë për një definim më të qartë dhe kjo veçmas kur merret parasysh fakti se qeverisja e Kosovës gjendet në fazën e transferit të kompetencave nga UNMIK-u në qeverinë vendore. Në disa aspekte, konfuzioni i kompetencave është aq i madh sa që ai mund të bëhet pengesë për një punë cilësore dhe efikase të sektorit në fjalë. Për shembull, çështja e menaxhimit të PTK-ës që

është kompetencë ekskluzive e Agjencisë për mirëbesim gjveshë në mënyrë absurde Ministrinë nga kompetencat legjitime për këtë çështje. Kjo ndodhë edhe me Kuvendin e Kosovës, i cili praktikisht nuk mund të ushtrojë kontrollin parlamentar mbi punën e institucioneve publike telekomunikuese, nevoja për të cilën është aq e madhe në këtë periudhë kur kihet parasysh fakti se PTK po ballafaqohet me probleme serioze.

Qarku i kompetencave midis aktorëve kompetentë për çështjet e telekomunikacionit, si Qeveria e Kosovës, Ministria, Përfaqësuesi Special i Sekretarit Gjeneral, Agjencia për Mirëbesim dhe Kuvendi i Kosovës aktualisht është një qark i hapur dhe si i tillë hapë rrugën për fenomenet negative të natyrës së korrupcionit, jokompetencës dhe punës joefikase. Prandaj, zgjidhja për këtë çështje duhet të reflektohet në Projektligjin për telekomunikacion.

Ndërkaq, sa i përket Kuvendit apo kompetencës së Kuvendit, mendoj se kjo çështje duhet të zhgjidhet sipas modelit që përfaqësuesi i Kuvendit të Kosovës të përfshihet në bordin e drejtorëve të Agjencisë për Mirëbesim ashtu siç ka propozuar Instituti Riinvest.

Këtij projektligji i mungon adresimi i çështjeve të teknologjisë informative. Siç jemi edhe vetë dëshmitarë zhvillimet botërore të shekullit 21 në aspektin e qeverisjes dhe të demokratizimit nxiten nga tre forca kryesore, atë të globalizimit; të marketizimit dhe të teknologjisë informative. Kjo e fundit, pra teknologjia informative, gjithnjë e më shumë po bëhet faktor për një qeverisje më kualitative duke e futur teknologjinë si mjet i punës dhe i mësimit. Prandaj, vizioni ynë për një zhvillim të drejtë dhe të shpejtë të Kosovës nuk mund të mendohet pa patur një vizion të qartë edhe për trendet e teknologjisë informative. Në këtë kuadër, një punë e mirë dhe inkurajuese po bëhet nga sektori privat, siç është rasti i Institutit "Ipko" dhe se në të ardhmen angazhimi në këtë drejtim duhet të ngritet në nivelin nacional. Për këtë arsye është e domosdoshme që çështjet e teknologjisë informataive të përfshihen në Ligjin mbi telekomunikacionin.

Një çështje tjetër me rëndësi që vlenë të shtrohet sot, ndonëse kjo çështje nuk është drejtpërdrejtë e lidhur me Ligjin është çështja e kodit telekomunikues për Kosovën. Edhe

pas tre vjetësh të veprimit të institucioneve të qeverisjes së përkohshme të Kosovës Kosova nuk e ka kodin e vet. Për më tepër ajo i ka dy kode ku njëri është kodi i ish okupatorit të saj, ndërsa tjetëri është kodi i huazuar nga Monako dhe për të cilin deri më tash janë shpenzuar rreth 50 milionë euro. Një ekonomi e dobët çfarë ne kemi sot në Kosovë natyrisht nuk e duron një qasje kaq iracionale, andaj mendoj se duhet gjetur forma që kjo çështje të zgjidhet. Në fakt, në aspektin politik, çështja e kodit mbetet mbrapa avancimeve që ka shënuar Kosova me statusin e protektoratit ndërkombëtar. Kjo praktikë mendoj se nuk mund të vazhdojë më tej. Përkundrazi, duhet të kërkohet ugjentisht një zgjidhje adekuate për kodin. Ekzistojnë dy opcione kryesore: 1. Që Kosovës t'i jipet kodi i cili i është ndarë nga ana e ATIU apo Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve në kohën kur Kosova ish njësi federale e ish Jugosllavisë. Në atë kohë ATIU ka ndarë 8 kode për ish Jugosllavinë, prej 381 në 389 siç e dijmë të gjithë, pra sipas 8 njësive federale dhe opcioni 2. është që UNMIK-u të kërkojë një kod të përkohshëm i cili i takon OKB-ës për realizimin e misionit të saj në bazë të marrëveshjes midis OKB-ës dhe ATIU-ës, saktësisht sipas nenit 16 të kësaj marraëveshjeje. Këto opcione mendoj se janë të realizueshme por që deri tani ka munguar një lobizim i koordinuar në këtë drejtim.

Një çështje tjetër është se teksti i Projektligjit, versioni shqip, ka shumë gabime të natyrës gjuhësore dhe profesionale, pra është një fenomen kronik që po ballafaqohemi, andaj ka nevojë që t'i nënshtrohet një lektorimi kompetent.

Në fund, më lejoni të theksoj se me një kontribut serioz të deputetëve dhe të faktorëve kompetentë për çështje të komunikacionit do të kemi një ligj të mirë i cili do t'i shërbejë mirë Kosovës dhe popullit të sajë. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit zonja Editë. E ka fjalën zoti Gojko Saviq. Le të bëhet gati zoti Kelmendi.

GOJKO SAVIĆ:

Poštovano Predsedništvo, cenjene kolege. Moje pitanje bi trebalo da bude tehničke prirode neposredno posle izlaganja ministra, medjutim u medjuvremenu je data reč koleginici i ne menja stvar samo sam hteo sledeće da kažem. Ministar je bio potpuno jasan u svom izlaganju i ogromna većina je jako dobro razumela. Ako pitate srpske poslanike niko sigurno nije ništa razumeo. Da bi se normalizovao prevod potrebno je bilo sat vremena. Znači tek je sada ovaj prevod koleginice išao korektan. Više se čuje šta se dešava u sali, njihovi razgovori, šegaćenje, menjanje ljudi. To znači samo za izlaganje ministra promenilo se tri prevodilaca. Neko čita, neko prevrće listove,nekome zvoni telefon, mi ne čujemo ništa. Od početka je tako bilo. Ja sam se žalio još kod glasanja da ništa ne razumemo i ja bih molio zaista predsednika da se strogo vodi računa kada je prevodjenje u pitanje i ovde u sali treba biti tišina i u prostoru gde su oni izdvojeni mora da biti tišina i da se zna ko prevodi na srpski jezik. To su sa takvim materijalnim greškama, mislim da je zaista nemoguće razumeti i jednu rečenicu a kamo li shvatiti suštinu onoga što neko želi da kaže. Samo toliko. Hvala.

KRYESUESI:

Zoti Saviq, ju falemnderit. Plotësisht pajtohem me këtë që thatë dhe që vazhdimisht po insistojmë në përmirësimin e shërbimeve të përkthimeve dhe shpresoj se vërejtja është shumë e qëlluar. Vazhdojmë më tutje. Zoti Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë dhe ministra. Duke u mbështetur në ndryshimet e proceseve demokratike në të cilat po kalon Kosova dhe në të arriturat shkencore, Ligji ekzistues apo i aplikueshëm mbi telekomunikacionin në Kosovë nuk i përmbushë as për së afërmi nevojat e sektorit të telekomunikacionit. Andaj, shqyrtimi dhe miratimi i Ligjit për telekomunikacionin në Kosovë është një hap i rëndësishëm dhe një nevojë e domosdoshme e zhvillimit të Kosovës. Ndonëse Ligji duhet liruar nga pjesa hyrëse

formale e cila tash disa herë po përsëritet dhe e cila nuk është trajtim i Ligjit, unë duke analitzuar Propozimligjin për telekomunikacinin në Kosovë propozoj disa sygjerime të cilat do ta begatonin atë po qe se inkorporohen në Ligj në tekstin përfundimtar të miratuar në këtë Kuvend, si vijon:

1. Propozimligji i telekomunikacionit të Kosovës nuk i siguron instrumentet juridike për ta ruajtur integritetin telekomunikativ në tërë Kosovën, nga se edhe tani pjesa veriore e Kosovës gjegjësisht Mitrovica është e çkyçur në këtë drejtim nga kjo e drejtë.
2. Vlerësoj se me menaxhimin e frekuencave do të duhej të përcaktohej dhe të bëhej nga një komision profesional i mediave... po ashtu ky propozim ligj nuk ofron dhe nuk përcakton kriteret për ndarjen e frekuencave.
3. Me këtë ligj duhet t'i sigurohet e drejta Ministrisë për sektorin e telekomunikacionit që Ministria të mund të marrë pjesë në takimet dhe bisedat me shtetet tjera kur bisedohet për telekomunikacionin e Kosovës dhe t'i lihet mundësi të lidhë marrëveshje me to, natyrisht me bashkësinë ndërkombëtare. Ky ligj nuk i qartëson kompetencat e etniteteve në lëminë e telekomunikacinit sepse mund të kemi etnitete të privilegjuara dhe të diskriminuara dhe dihet ky propozim i ligjit nuk i përcakton instrumentet juridike me të cilat qeverisë të gjitha shërbimet e telekomunikacionit në Kosovë për të krijuar ambient ligjor dhe transparent i cili do t'i promovojë investimet dhe konkurencën e lirë për t'i përmbushur nevojat e të gjithë shfrytëzuesve për shërbimet telekomunikative të përcaktuar me dispozitat e nenit 1.

Në nenin 2, mes tjerash thuhet: Duhet të merr parasysh. Unë mendoj se kjo "duhet të merr parasysh" duhet të përcaktohet se a i mer apo nuk i merr parasysh rregullativat e Bashkësisë Evropiane, dhe "duhet" është alternativë.

Po ashtu, në nenin 3, duhet precizuar se Ministria mban përgjegjësinë duke përcaktuar cilat janë përgjegjësitë e saj dhe cilat janë të UNMIK-ut përkatësisht special. Pa një saktësim të tillë, ligji mbetet i mangët.

Emërimi i bordit të drejtorëve të ART-ës. Duhet përcaktuar saktësisht mënyra e zgjedhjes, detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë dhe këto janë trajtuar në nenin 7 dhe 6, duke përjashtuar konsultimin e kryeministrit dhe duke hequr kriterin dhjejtëvjeçar profesional ngase këto janë tërësisht në kundërshtim me Ligjin themelor të punës në Kosovë 2001/27.

Vlerësoj se shkarkimi i anëtarit të bordit për shkak të dënimit për kundërvajtje është i padrejtë. Më duket se këtu nuk ka arsyetim më tepër. Caktimi i dënimit nga ana e ART-ës për pagimin e vlefshëm të tarifës së lartë prej 25% të tarifës që nuk është paguar është i paarsyeshëm dhe kjo lartësi duhet zvogëluar në masën e kamatave bankiere. ART për shkak të punës publike duhet lënë mundësi që të caktojë seanca publike në çdo 6 muaj dhe jo në kompetenca të ART-ës dhe sipas dëshirës.

Në nenin 11 pika 4 ku bëhet fjalë për të drejtat e ankesës dhe zgjedhjes së konflikteve në të drejtë për apelim ART ka lënë një afat prej 6 javës e po ashtu afati është shumë i lartë, 6 javë për të dhënë përgjegje në ankesë është tepër.

Me nenin 18 autoriteti i ART-ës duhet ushtruar pushtetin e vet duke lëshuar autorizime dhe licenca për shërbime të telekomunikacionit edhe në Kosovën veriore dhe në Mitrovicë pjesë e së cilës Kosovës i është mohuar e drejta e shfrytëzimit të telefonave.

Në nenin 26 ky propozimligj jep zgjedhje për radiofrekuenca që janë akorduar për nevojat kombëtare, gjë që është në rregull, por nuk jep zgjedhje për frekuencat radio-lokale sipas planit për shfrytëzimin e radio-frekuencave të përcaktuara me nenin 63 gjegjësisht nuk e cakton elementin e tarifës dhe pagës për marrjen e të drejtës për përdorimin e radio-frekuencave.

Dhe, po e përfundoj. Me nenin 37 parashihet ndarja dhe transformimi i numrave por nuk e përcakton kthimin e të drejtës në numrin posedues të transformuar, si për shembull, siç ka ndodhur në Mitrovicë dhe në Mitrovicën veriore ku shqiptarëve u janë marrë numrat

dhe atyre nuk u kthehet e drejta për shfrytëzimin e këtyre numrave dhe për të kërkuar shërbime gjegjësisht për të kryer shërbime.

Tenderi mbi shërbimet e frekuencave patjetër duhet të jetë publik dhe mbi kriteret e publikuara përpara për t'u ikur metodave tjera të malverzimeve dhe keqpërdorimeve. Me këtë propozimligj do të jenë të miratuara edhe këto karakteristika. Me rastin e thirrjeve, shqetësimeve, kërcnimeve, ofendimeve, shërbimeve jo të ndershme përmes shërbimit të telefonit, shërbimi të sigurojë identifikimin e thirrësit dhe për këtë të parasheh masa ndëshkuese e nëse jo atëherë për ata të cilët i udhëheqin ato njësi telekomunikacioni. Shërbimi i ART duhet të sigurojë kartela telefonike në zyrat e PTT dhe jo në tregun e zi, në rrugë, ku bëhet stërshitja e tyre. Dhe, në nenin 5 pika 4 duhet të shtohet edhe kjo: Ministria duhet t'i propozoj Kuvendit dhe Qeverisë llogarinë përfundimtare të mjeteve të harxhuara për vitin paraprak; duhet të përcaktojë emërtimin e saktë të fondit për financimin e veprimtarisë telekomunikative; Ministria duhet të bëjë planin e mjeteve financiare për financimin e veprimtarive të telekomunikacionit nga mjetet plotësuese që nevojiten për vitin vijues dhe duhet patjetër që tarifa për rregullimin e shërbimeve të telekomunikacionit të aprovohet nga Qeveria apo ndonjë organ i Kuvendit.

Gjoba e denimet dhe mjetet e inkasuara nga kjo sferë e buxhetit të derdhen në fondin e Buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Zoti Kelmendi, ju falemnderit. Urdhëro, zoti Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

Nuk ka dyshim se si ky ligj ashtu edhe të gjitha ligjet tjera që po i miraton Kuvendi i Kosovës janë shumë të rëndësishëm për funksioinimin e jetës këtu te ne. Ky ligj është me rëndësi sepse bazohet në ligjet ndërkombëtare dhe kanë punuar ekspertët ndërkombëtarë e vendorë për ta hartuar këtë ligj dhe ne i përgëzojmë dhe përshëndesim si Ministrinë po

ashtu edhe ekspertët të cilët na e kanë ofruar këtë ligj ta shqyrtojmë në parim në Kuvendin e Kosovës. Është me rëndësi se ky ligj do ta lejojë konkurencën siç u tha edhe më herët sepse bash konkurenca, moslejimi i konkurencës në frekuenca ka qenë e meta më e madhe dhe ka qenë ai pësimi,më i madh që kanë pasur qytetarët tanë. Por, unë e kam një brengë e po ashtu besoj se edhe shumë deputetë e kanë se të ashtuquajturat pjesë e rezervuar po e pengojnë zhvillimin e Kosovës dhe po e pengojnë edhe miratimin e ligjeve. Dhe, mendoj se duhet të shqyrtohet me një theks të veçantë se deri kur duhet të jenë këto pjesë të rezervuara, kompetenca të rezervuara dhe a mund të funksionojë ky ligj edhe pas miratimit nga Kuvendi. Kjo është një pikëpyetje që po ndodh me shumë ligje që po i miraton Kuvendi dhe mendojmë se e do një përgjigje nga Kuvendi në një të ardhme të afërt. Si grup parlamentar mbështesim në parim këtë ligj. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Zoti Hyseni.

HYDAJET HYSENI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar ministra. Kosovës i duhet një ligj i mirëfillt për komunikacionin dhe ne e mbështesim. Por, e konsideroj të pazakonshme që ne po bisedojmë për ligjin pa e shqyrtuar një herë gjendjen në këtë fushë shumë të rëndësishme dhe shumë të ndieshme. Kosovës i duhet një veprimtari ekstensive ligjdhënëse dhe unë mbështes një zhvillim të tillë, por kjo nuk do të thotë se ne duhet t'i kalojmë ligjet shkel e shko.

Në Projektligjin e propozuar unë kam një sërë vërejtjesh. Do t'i shquaj disa. Së pari si zakonisht projektligjet kanë një shpërputhje të madhe midis versioneve të gjuhë të ndryshme, por kjo nuk është vetëm çështje gjuhësore por kthehet shpesh edhe në çështje përmbajtësore. Po përmendi vetëm kalimthi disa shembuj të cilët, jam i sugurt, nuk janë ndoshta më drastiket. Shikoni vetëm preambulën e projektligjeve në gjuhën shqipe dhe asaj në gjuhën angleze. Edhe formalisht, pasuset janë të zëvendësuara. Flitet për etnitetet,

në poste e telekomunikacion. Kur e sheh në versionin orgjinal e sheh se është fjala për "entitetet" por në gjuhën shqipe ajo është "etnitetet". Diku kjo "entitetet" pastaj është përkthyer "njësitë" dhe merreni me mend si do të duket kjo pastaj gjatë zbatimit. Edhe kur flitet pastaj për institucionet që dalin nga ky ligj, në një vend flitet se ligji mbështetet në "autoritetin", në anglisht, e në shqip është në "rregulloren". Në shqip flitiet për "autoritetin" që do të themelohet për rregullator që është për telekomunikacion, kurse në anglisht është "agjensi". Nuk besoj se janë ekuivalente. Kjo "agjensi" në gjuhën angleze është shkruar me shkronjë të vogël, do të thotë është një emërtim i përgjithshëm, kurse në gjuhën shqipe është me shkronjë të madhe, do të thotë është emër i një institucioni. Në anglisht flitet për "kompetishën" që mund të përkthehet sipas anglishtës sime modeste me një "konkurencë" ose "garë", kurse në gjuhën shqipe është ky formulim: "Konkurencë lojale në përputhje me dispozitat në fuqi". Në anglisht është vetëm një shprehje "kompetishën". Edhe shprehja "provajders" në anglisht, e që në shqip është "bartësit", këtu është përkthyer në disa forma, në rastin më të shpeshtë "ofruesit". Nuk besoj se shprehja "ofruesit e shërbimeve të telekomunikacionit" e mbulon kuptimin e shprehjes "provajders" që do të thotë bartës sepse ofruesit mund të jenë edhe ata që ofrojnë por nuk janë të nominuar si bartës të shërbimeve dhe është çështje që do të ketë pastaj pasoja në praktikë. E për të mos shkuar kështu me radhë, flitet për ligjet ose rregulloret tjera aplikative të UNMIK-ut. Shtrohet çështja cilat janë ligjet e UNMIK-ut? Në anglisht pastaj shihet se është fjala për ligjet dhe rregulloret, do të thotë, ligjet e zbatueshme dhe rregulloret e UNMIK-ut që janë dy çështje.

Për të mos shkuar më tej, mendoj se duhet të shfrytëzohet ndoshta ky rast që Projektligji të ketë përmbajtje të njëjtë në të gjitha gjuhët dhe kjo pastaj të kihet parasysh edhe për rastet tjera.

Kam edhe një vërejtje tjetër që është përmbajtësore. Një pjesë e madhe e Projektligjit është shkruar në formën: Ministria ose institucioni që do të krijohet do të bëjë këtë, do të rregullojë këtë dhe nuk kuptohet a është këtu fjala për një program qeveritar ose ministrie apo është një ligj. Ligji nuk përshkruan se çka do të bëhet por ligji përshkruan çka është dhe bëhet, çka sanksionohet e tjera.

Tre, kam një vërejtje që mendoj se mund të bëhet pyetje. Flitet për ligjet aplikative. Pyetja ime është cilat janë ligjet aplikative në Kosovë dhe çka do të thotë – ligje aplikative?

Katër, kam një pyetje për ministrin. Me nenin 48 parashihet "koçesioni për telefoninë fikse". Do të dëshiroja të dij – mbi ç'baza është ndërtuar një qëndrim i tillë që lejon mundësinë që edhe në telefoninë fikse në një mënyrë të jepen koçesione për të interesuar dhe do të dëshiroj të dij – cila është përvoja e vendeve në tranzicion. Çka do të thotë kjo për Kosovën, për buxhetin e saj edhe ashtu të hollë?

Edhe një vërejtje të fundit që, mendoj, mund të jetë edhe kërkesë. Edhe në këtë projektligj është paraparë mundësia që për bartësit e interesuar të shërbimeve të telekomunikacionit, një institucion që do të krijohet në kuadër të Ministrisë e që nuk sqarohet çka do të jetë, do të organizojë dhe do të shpallë tenderet për këto. Unë nuk dij cilat do të jenë mundësitë e kontrollit parlamentar për çështjet e tilla të ndjeshme. Kërkesa ime është që të sigurohet kjo mundësi që parlamenti të ketë kontrollin e duhur në çështje të tilla dhe, kur e them këtë, kam parasysh edhe gjendjen aktuale në telekomunikacion dhe gjithë atë që në opinion flitet e shkruhet, kurse institucionalisht, nuk trajtohet dhe nuk shqyrtohet. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit zoti Hyseni. Besoj se diskutimi në parim ishte i bollshëm dhe konstruktiv. Mendoj që sponzorizuesi i Ligjit do t'i ketë këto parasysh. Para se ta hudhim në votë formale, lus komisionet përkatëse, do të thotë Komisioni funksional për komunikacion e telekomunikim dhe Komisioni për buxhet dhe ai i interesave të komuniteteve që vërtetë menjëherë t'i marrin në shqyrtim dhe kjo vlenë për shqyrtimet e para në parim.

Ftoj deputetët – kush është që në parim të aprovohet Projektligji i propozuar nga Ministria për Telekomunikacion. I numëroni votat, ju lutem.

Kush është kundër aprovimit në parim të këtij projektligji?
A abstenon ndokush nga votimi?

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For.....76

Kundër – Protiv – Against 04

Abstenuan – Uzdržanih - Abstaned.....06

KRYESUESI:

Ju ftoj për një pauzë prej 20 minutash deri në shqyrtimin e ligjit të ardhshëm. Ju falemnderit.

(Vijon pauza)

Seanca vazhdoi punën pas pauze.

KRYESUESI NEXHAT DACI, KRYETAR I KUVENDIT:

Një sygjerim para se të kalojmë në Shqyrtimin e parë të Projektligjit. Vërejtjet që janë bërë nga zyra legale e zotit Steiner, atë që u tha në fillim të hyrjes. Unë kam lutur që t'i shpërndahen komisioneve përkatëse, prandaj i lus të gjithë deputetët ose grupet parlamentare që kanë ndonjë propozim konkret për përmirësimin e cilësisë së çdo ligji, që në formë të amendamentuar me kohë t'i paraqesin propozimet e veta komisionet me

mund në mënyrë profesionale me i shqyrtuar të gjitha ato vërejtje. Vazhdojmë. Ftoj ministrin për ambient, zotin Çeku që ta merrë fjalën hyrëse për sqarimet në parim të draftligjit të propozuar.

ETHEM ÇEKU:

Të falemnderit kryetar, të nderuar deputetë. Situata e rëndë dhe e trashëguar nga lufta e fundit në Kosovë ka ndikuar në krijimin e një gjendjeje të rëndë edhe në sferën e ambientit. Është e rëndësishme me këtë rast të theksojmë se, sipas shumë hulumtimeve të bëra viteve të fundit nga institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare me renome, Kosova është radhitur në krye të listës së vendeve më të ndotura në Evropë, ku niveli i disa ndotësve ka kaluar për dhjetëra herë standardet e lejuara sidomos në dy qendrat kryesore industriale të saj në Prishtinë dhe Mitrovicë. Për ta ilustruar këtë të dhënë, duhet përmendur se koncentrimi i plumbit në gjakun e qytetarëve të Mitrovicës, sipas studimeve të Organizatës botërore të shëndetësisë, është rreth 40 herë më i lartë sesa standardet e lejuara, ndërsa, sipas Organizatës për bujqësi dhe ushqim, ky nivel në perime është 15 herë më i lartë sesa standardet e lejuara. Kjo shkallë kaq e lartë e ndotjes është pasojë e rrethanave të cilat dalin nga këto fakte: Ekonomia e Kosovës ka qenë e bazuar kryesisht në shfrytëzimin enorm të resurseve natyrore ekziestuese të cilat kanë prodhuar sasi të mëdha të ndotjes dhe të mbeturinave; teknologjia industriale në operim ka qenë e vjetër dhe pa kurrfarë riparimesh sidomos në dy dekadat e fundit; mungesa e një sistemi të mirëfilltë të monitorimit të ambientit jetësor duke përfshirë ajrin, ujin, tokën dhe biodiversitetin. Strukturat administrative dhe institucionale në të kaluarën sa i përket problematikës së mbrojtjes së ambientit nuk ka qenë e definuar qartë si në vijën horizontale ashtu edhe në atë vertikale dhe mungesa e theksuart e legjislacionit mjedisor si dhe zbatueshmëria e dobët e atij legjislacioni të pakt ekzistues të aplikueshëm në Kosovë në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24.

Të nderuar deputetë, në mbështetje të dispozitave të Kornizës kushtetuese për vetëqeverisjen e përkohshme në Kosovë dhe Rregullores mbi degët ekzekutive të

institucioneve të përkohshme, Ministria e Ambientit dhe e Planifikimit Hapësiror, pos tjerash është përgjegjëse edhe për:

- menaxhimin e përgjithshëm të çështjes së mbrojtjes së ambientit në Kosovë,
- krijimin e politikës së gjithmbarshme,
- zbatimin e ligjeve dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve për mbrojtjen e ambientit, duke përfshirë edhe resurset e ujit, ajrit, tokës dhe biodiversitetin,
- vendosjen e normave, standardeve dhe nxjerrja e udhëzimeve për lëminë e mbrojtjes së ambientit duke respektuar standardet relevante ndërkombëtare.

Për implementimin e këtyre përgjegjësive nga fushëveprimtaria e Ministrisë është parakusht krijimi dhe zbatimi i bazave ligjore, normave dhe standardeve relevante për mbrojtjen e ambientit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Kosovës deri sot i ka munguar legjislacioni bazë për mbrojtjen e ambientit duke përfshirë mbrojtjen e ajrit, ujit, tokës, biodiversitetit si dhe mbrojtja nga mbeteurinat dhe materiet tjera të rrezikshme.

Projektligji për mbrojtjen e ambientit që gjendet sot para jush për miratim është një Ligj i përpiluar dhe i përpunuar hollësisht për të siguruar një bazë të re ligjore për një mbrojtje më efikase të ambientit jetësor në Kosovë. Ligji për mbrojtjen e ambientit i paraparë edhe me Programin e Kuvendit dhe të Qeverisë për vitin 2002 është harmonizuar me legjisladcionet më të reja nga lëmia e mbrojtjes së ambientit në rajon, pastaj me norma dhe konventa ndërkombëtare si dhe me direktivat evropiane në lidhje me standardet dhe normat për mbrojtjen e ambientit. Ky projektligj është përpunuar nga ekspertë të njohur dhe të dëshmuar vendor, në bashkëpunim me ekspertë të njohur dhe të dëshmuar ligjor ndërkombëtar që kanë specializuar në vende të ndryshme evropiane dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në problematikën e legjislacionit nga fusha e mbrojtjes së ambientit.

Ky projektligj që po ofrohet sot para jush synon ta çojë Kosovën drejt integrimeve evropiane edhe në fushën e mbrojtjes së ambientit duke pasur parasysh se mbrojtja e ambientit është një nga kushtet kryesore në këto integrime.

Sipas këtij projektligji organ përgjegjës që siguron administrimin e mbrojtjes së ambientit janë: Kuvendi i Kosovës, Qeveria, Ministria e Ambientit dhe e Planifikimit Hapësiror, komuna, qytetarët dhe grupet e ndryshme të qytetarëve, organizatat e shërbimeve publike komunale, subjektet juridike, shoqëritë tregtare si dhe organizatat e institucionet tjera. Secila nga këto nivele rregullon çështjen e mbrojtjes së ambientit nëpërmjet akteve përbrenda kompetencave të veta. Në këtë mënyrë në Projektligj janë përshirë parimet kryesore të mbrojtjes së ambientit që sot aplikohen në vendet më të përparuara të botës siç janë: parimi i zhvillimit të qëndrueshëm përmes të cilit zhvillimi i gjeneratës së tashme do të ketë parasysh dhe nuk do të cenojë zhvillimin e gjeneratave të ardhshme. Ky është parim bazë i dalur nga Samiti i tokës mbi zhvillimin e qëndrueshëm i cili u mbajt në muajin e kaluar në Johanesburg të Afrikës Jugore. Parimi – ndotësi paguan, që nënkupton heqjen e shpenzimeve dhe kompensimeve për cenim dhe rrezikim të ambientit, eliminimin e dëmtimeve, shpenzimet për dëmet ndaj shëndetit publik, kompensimi për shfrytëzimin e resurseve natyrore dhe obligimi për rikultivimin dhe rihabilitimin e sipërfaqeve të degraduara;. Parimi i vlerësimit të ndikimit në ambient që paraqet një masë parandaluese të ndikimit negativ të projekteve në ambientin jetësor nëpërmjet një studimi paraprak të këtyre ndikimeve.

Me këtë projektligj pra përcaktohen parimet themelore të mbrojtjes së ambientit, përgjegjësitë e institucioneve të Kosovës si dhe palët juridke dhe fizike për sigurimin e kushteve dhe masave për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të ambientit. Këtu përfshihen edhe detyrimet për përdorimin me përgjegjësi të resurseve natyrore me qëllim të realizimit të së drejtës së qytetarëve për ambient të shëndoshë dhe zhvillim të qëndrueshëm. Po ashtu, në Projektligj janë paraparë edhe nevojat e barazpeshës në mes zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së ambientit, përkatësisht respektimit të principeve ekologjike gjatë fazave të këtij zhvillimi. Me projektligj synohet harmonizimi i strukturës dhe i aktiviteteve zhvillimore të ndërmarrjeve ekonomike dhe ndërmarrjeve tjera me

kushte ambientale në mënyrë që plotësimi i nevojave të gjeneratës së tashme të mos cenojë të drejtën e gjeneratave të ardhshme për një ambient të shëndoshë dhe zhvillim të qëndrueshëm. Një veçanti tjetër e këtij projektligji qëndron në krijimin e rregullave për parandalimin dhe përkufizimin e ndotjes dhe degradimin e ambientit si pasojë e shkarkimeve dhe përhapjes së materieve të dëmshme dhe të atyre të rrezikshme në ajr, ujë dhe tokë, si dhe degradimet e ambientit të shkaktuara nga shfrytëzimi i resurseve natyrore. Masat parandaluese të mbrojtjes së ambientit do të sigurohen përmes vlerësimit të ndikimit në ambient të objekteve industriale e prodhuese, përmes pëlqimeve ambientale, lejeve ekologjike dhe autorizimeve ambientale, monitorimeve dhe inspektimeve.

Me anë të këtij projektligji përcaktohen dokumentet bazë për mbrojtjen e ambientit të cilat janë: Strategjia e Kosovës për mbrojtjen e ambientit të cilën me propozim të Qeverisë e miraton Kuvendi i Kosovës. Kjo strategji përcakton synimet, udhëzimet dhe konceptet për mbrojtjen e ambientit për një periudhë dhjetëvjeçare; Programi për mbrojtjen e ambientit në sfera të veçanta, të cilin e nxjerr në çdo 5 vjet Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë...Këto programe kanë të bëjnë me mbrojtjen e ajrit, ujit, tokës, biodiversitetit, me mbrojtjen nga radioaktiviteti, me mbrojtjen nga zhurma si dhe me menaxhimin me mbeturina të rrezikshme; Aktet e planifikimit dhe rregullimit hapësiror, të cilat përfshijnë vlerësimin e aktivitetit të planifikuar dhe ndikimit të tyre... janë: raportet për gjendjen e ambientitit të cilin Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë ia paraqet Kuvendit të Kosovës për periudhën dyvjeçare. Ky raport përfshin gjendjen dhe ndryshimet e ambientit, ndikimet në ambientin e shëndetit publik, shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, zbatimin e programeve për mbrojtjen e ambientit. Me Projektligj gjithashtu përcaktohen detyrat e institucioneve të cilat kanë përgjegjësinë kryesore sa i përket mbrojtjes së ambientit në Kosovë. Këtu kemi të bëjmë me krijimin e Agjencionit të Kosovës për mbrojtjen e ambientit i cili do të sigurojë monitorimin e ambientit në nivel të vendit. Në kuadër të këtij agjencioni do të veprojë Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit i Kosovës, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës dhe Institucioni i Vlerësimit të Ndikimit në Ambient. Në këtë agjencion funksionon edhe sistemi informativ për mbrojtjen e ambientit i cili do të mbledhë të

dhënat për shkallën e mbrojtjes së ambientit në Kosovë dhe do të ofrojë qasje për publikun në këto informacione. Ky sistem informativ përfshin informacionet për burimet natyrore, çrregullimet ambientale, substancat e dëmshme dhe të rrezikshme, dëmtimet dhe aksidentet ekologjike, zonat e mbrojtura të natyrës, diversitetin biologjik e tjera. Ministria do të përcjellë dhe do të mbajë kadastrën e ndotësve në nivel të Kosovës i cili do të përfshijë regjistrin e materieve të dëmshme dhe të rrezikshme. Po ashtu me Projektligj është paraparë edhe emërimi i bordit këshillues për mbrojtjen e ambientit nga Kuvendi i Kosovës i cili do të përbëhet nga ekspertë dhe shkencëtarë të dalluar në fushën e mbrojtjes së ambientit. Ky bord do të japë mendime, sygjerime, propozime për Kuvendin e Kosovës dhe do ta informojë publikun për gjendjen dhe trendet e ambientit në Kosovë.

Risi e veçantë i është dhënë edhe mbikëqyrjes profesionale dhe inspektimeve në zbatimin dhe implementimin e dispozitave të këtij ligji. Kjo do të arrihet përmes institucionit të inspektoratit, përkatësisht të inspektorëve të ambientit të cilëve u janë definuar autorizimet, kompetencat dhe detyrimet sipas dispozitave ligjore.

Në projektligj për mbrojtjen e ambientit është paraparë edhe mundësia që përmes instrumenteve ekonomike të sigurohet edhe një mekanizëm efikas për zbatimin e projekteve të mbrojtjes së ambientit. Kjo do të arrihet përmes një ligji që në të ardhmen do ta themelojë fondin e Kosovës për ambient ose eko-fondin ngjashëm si edhe në vendet tjera prej nga do të sigurohen burimet financiare, nga kompensimet, gjobat dhe taksat nga lëmitë e ambientit të cilat gjithashtu janë paraparë në dispozitat ndëshkimore të këtij projektligji.

Të nderuar deputetë, gjatë hartimit të Projektligjit janë konsultuar dhe njëkohësisht draftligji i është adresuar të gjitha institucioneve relevante shkencore duke përshirë edhe Akademinë e Shkencave dhe të Artee të Kosovës dhe departamentet e veçanta të fakulteteve të Universitetit të Prishtinës, pastaj institucioneve kërkimore, Institutit kombëtar të shëndetit publik, Institutit për Projekte zhvillimore, Instituti për mbrojtjen e

natyrës dhe ambientit në Kosovës dhe Institutit hidrometeorologjik të Kosovës të cilët kanë dhënë kontribut të çmuar në hartimin e Projektit të këtij ligji.

Projektligji për mbrojtjen e ambientit ka kaluar fazën e konsultimeve ndërministrore me ministrat tjerë të Qeverisë së Kosovës, posaçërisht me ata me të cilët më së shumti kanë të bëjnë dispozitat e këtij projektligji, siç janë Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Shërbimeve Publike. Vlenë të potencohet se për këtë Projektligj është konsultuar edhe Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit i cili ka dhënë vlerësimin pozitiv. Po ashtu është praktikuar edhe pjesëmarrja e publikut në fazën e konsultimeve, nëpërmes të seminareve dhe takimeve të punës kryesisht me organizata joqeveritare të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes së ambientit.

Në fund, për të dëshmuar se sa është i rëndësishëm ky ligj për Kosovën, po përcjellim një konkluzion të raportit për rishqyrtimin e aktivitetit në ambient, të përpiluar nga Komisioni ekonomik evropian i Kombeve të Bashkuara që do të publikohet muajin e ardhshëm në Gjenevë në të cilin përpos që vlerësohet pozitivisht Projektligji, thuhet: Pa aprovimin e këtij ligji në Kosovë, Ministria e Ambientit dhe e Planifikimit Hapësiror është në masë të madhe e pafuqishme të veprojë. Prandaj, është koha që të veprojmë sepse e kemi borxh moral e institucional, politik e kombëtar që t'iu sigurojmë fëmijëve tanë një ambient dhe një të ardhme më të pasur dhe më të shëndoshë. Miratimi i këtij projektligji sot nga ju, deputet të nderuar, do të sigurojë një ardhmëri më të mirë ambientale në Kosovë. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Zoti ministër, ju falemnderit. Ftoj deputetët të paraqiten në debat në shqyrtim të parë, një debat i cili do të përqëndrohet në parim e jo në detaje. Sanije urdhëroni.

SANIJE ALIAJ:

I nderuar zoti kryetar, të nderuar ministra, kolegë të nderuar. Shpreh kënaqësinë time që sot në këtë seancë plenare bëhet leximi i parë për dy projektligje që janë shumë të rëndësishme për Kosovën. Por, nuk mund të kalojë në diskutimin parimor të Projektligjit për ambientin, pa shpreh dhembjen time të madhe për humbjen e bashkëvendasit tim, zotit Ukë Bytyqi. Atë ditë u vra qytetari i parë i Komunës së Therandës, qytetari shumë i respektuar i Kosovës. Jam plotësisht e vetëdijshme se në Kosovë qytetarët e Kosovës e dëshirojnë urtësinë, e dëshirojnë tolerancën dhe prosperitetin e Kosovës, por, fatkeqësisht, jo të gjithë.

Duke u nisur nga ajo se shoqëria e Kosovës është duke u ballafaquar me probleme të shumta në lëmin e mbrojtjes së ambientit, ky projektligj ofron të gjitha mundësitë për një ambient të shëndoshë dhe zhvillim të qëndrueshëm, ofron mundësitë për krijimin e rregullave për parandalimin e përhapjeve të materieve të dëmshme dhe të rrezikshme në ajr, ujë dhe në tokë. Me vetë faktin që për hartimin e këtij projektligji janë konsultuar të gjitha institucionet relevante shkencore e arsimore të Kosovës dhe se është harmonizuar me legjislacionet më të reja nga lëmi i mbrojtjes së ambientit në rajon dhe me normat e parimet e standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e ambientit, shton shpresë që ky projektligj do të krijojë mundësi dhe hapësirë për zhvillimin ekonomik dhe krahas kësaj edhe rregullimin dhe mbrojtjen e ambientit të shëndoshë në Kosovë që është kusht primar për ruajtjen e shëndetit të njeriut.

Ajo çka është më e rëndësishme në këtë projektligj është parimi i masave inkurajuese dhe stimuluese për regullimin dhe mbrojtjen e ambientit për qyetarët e Kosovës si dhe parimi i ndërgjegjësimit dhe edukimit përkatësisht ngritjes së vetëdijes për ambient të pastër dhe të shëndoshë. Ky projektligj, me të gjitha dispozitat pozitive që ka, konsideroj, sipas vlerësimit tim, se mund të aplikohet dhe mund të implementohnet vetëm pas hartimit të planit hapësiror të Kosovës, që unë jam plotësisht e vetëdijshme se kërkon numër të madh të mjeteve dhe pas hartimit të planit hapësiror të komunave dhe planit të menaxhimit të resurseve natyrore të cilat kanë një ndikim të madh në mbrojtjen e

ambientit. Konsideroj se Qeveria e Kosovës ngutshëm duhet të nxjerrë akte për caktimin dhe mbrojtjen e parqeve nacionale, që edhe më parë ishte shpallur, si për Malet e Sharrit Park nacional i Kosovës, por ky akt duhet të fuqizohet, përcaktimi dhe mbrojtja e burimeve termike, rajoneve rekreative dhe banjove në Kosovë.

Në kapitullin 10, neni 52 Aktet e Qeverisë dhe aktet ministrore, propozoj që Qeveria të nxjerrë aktet nga 24 muaj, siç është parparë në Ligj t'i nxjerrë brenda 12 muajve, e ministria t'i miratojë udhëzimet nga 36 muaj siç është brenda 18 muajve, kurse komunat t'i harmonizojnë aktet për aktivitetet e tyre në dispozitat e këtij ligji në afatin për 24 muaj, se përndryshe ambienti në Kosovë edhe më tutje, jo që do të përmirësohet, por do të shkatërrohet. Dhe argumenti tjetër pse e bëj këtë propozim është se konsideroj që Qeveria aktuale e Kosovës duhet t'i rregullojë shumicën e çështjeve brenda mandatit që ka. Këtë e kemi për obligim edhe si Kuvend. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Zonja Alijaj, ju falemnderit. Kemi dhjetë të paraqitur deri më tani. Unë do t'i lutja të gjithë deputetët që të jenë sa më koncizë dhe do t'u jepet mundësia të gjithëve. Zoti Haki Shatri dhe le të përgatitet Smiljka Millosavleviq.

HAKI SHATRI:

I nderuar zoti kryetar, kolegë deputetë dhe anëtarë të Qeverisë. Nevoja për nxjerrjen sa më parë të Ligjit mbi mbrojtjen e ambientit për të gjithë ne është shumë e qartë dhe e arsyeshme. Qasja e pavonesë e hartuesit të këtij projektligji dhe e propozuesit për përgatitjen dhe procedimin e këtij dokumenti të rëndësishëm është argument se institucionet përkatëse qeveritare me përgjegjësi dhe kompetencë i janë qasur zgjidhjeve të problemeve akute të njeriut dhe shoqërisë kosovare, siç është problemi i mbrojtjes së ambientit. Duke respektuar angazhimnin e organeve tona ekzekutive, si dhe duke respektuar fjalën hyrëse të zotit ministër, më lejoni që t'i shpreh shqetësimet e mia lidhur me disa zgjidhje të cilat në këtë projektligj janë propozuar e të cilat nëse aprovohen si të

tilla gjatë zbatimit të tyre do të prodhojnë efekte negataive dhe pengesa në zhvillimin ekonomik.

Së pari. Nuk është respektuar parimi i barazpeshës në mes qëllimit për zhvillimin dinamik ekonomik dhe kërkesës për mbrojtjen e ambientit. Pra, nuk është gjend pika oportune për kushtet dhe nivelin e ekonomisë kosovare aktuale. Zgjidhjet e propozuara në disa nga dispozitat e këtij projektligji janë në kundërshtim me qëllimet e Programit të Qeverisë për stimulimin e zhvillimit ekonomik, pasi që ato gjatë zbatimit komplikojnë procedurat, pengojnë dhe ngarkojnë bizneset, ngrisin koston dhe dekurajojnë investimet potenciale të vendit dhe të jashtme. Sistemi i vlerësimeve të ambientit, studimeve për mundësinë dhe lejet e parapara në këtë draft do të kenë efekt në çdo aspekt të prodhimtarisë në Kosovë dhe në mënyrë serioze do të pamundësojnë ose thjesht do të pengojnë në rritjen e iniciativave të shumta dhe normale të ndërmarrësve, të bizneseve, të individëve në fushëveprimtarinë e tyre normale dhe sjelljes së tyre në treg. Nuk ka vlerësim për ndikimin në buxhet, sidomos te agjencioni i propozuar që do ta menaxhojë me dy institucionet përkatëse. Pasi me këtë ligj do të krijohet agjencioni për mbrojtjen e ambientit dhe bordi mbikëqyrës për mbrojtjen e ambientit, ndikimi i tyre në buxhet nuk është matë dhe nuk është peshuar si duhet. Për përmbaruesit në të dy nivelet – qendror dhe atë lokal mundëson jotransparencë, kurse për bizneset fillestare komplikon tejmase procedurën e marrjes së licencës. Këtu në Ligj quhet – pëlqimi ambiental, dhe në këtë mënyrë krijon mundësi për sjellje eventuale burokratike dhe stimulon eventualisht korrupcionin te autoritetet të cilat do të vlerësojnë dhënien e pëlqimit për ambientin në nivele lokale apo qoftë edhe qendrore.

Këto që u cekën më lartë, argumentohen me faktin se nuk janë definuar dhe nuk janë përcaktuar parametrat dhe kufijt e vlerave për matjen e çrregullimeve ambientale në këtë ligj dhe nuk janë përkufizuar kompetencat e zyrtarëve në të dy nivelet të cilat kanë implikime materiale edhe në Buxhetin e Kosovës dhe në stimulimin e zhvillimit ekonomik.

Propozimi për formimin e eko-fondit dhe vënien e takstave është në kundërshtim me disa nga ligjet tona tashmë të aprovuara, aktet tjera në fuqi dhe orientimet programore të Qeverisë. E kam fjalën këtu edhe për disa draftligje që janë në procedurë të përpunimit që kanë mbrri edhe deri në Qeveri ose që kanë kaluar edhe te Komisioni ekonomik e fiskal. Nuk janë përcaktuar se cilat janë subjektet të cilat duhet të bëjnë hartimin e vlerësimit të ndikimit në ambient. Është bërë delegimi i padefinuar nga Kuvendi te Qeveria, ministria dhe te komunat. Prandaj, duke i lutur hartuesit dhe propozuesit për mirëkuptim, propozoj që propozuesi ta tërheqë nga procedura e miratimit. Pa u vonuar të eliminohen disa nga zgjidhjet e ofruara që nuk janë të pranueshme dhe, në një afat që do ta caktojmë këtu tani, t'i procedohet Kuvendit për miratim. Mendoj se kjo është rruga më e shkurtër për përgatitjen dhe miratimin në Kuvend të këtij dokumenti të rëndësishëm. Përndryshe, në qoftë se procedohet, vazhdimi i procedimit përmes metodës së propozimit të amendamenteve, do të komplikojë dhe zvarrisë shumë më shumë nxjerrjen e këtij ligji që, për ne të gjithë, konsiderohet si i rëndësishëm. Njëkohësisht, kërkoj nga të gjitha komisionet kompetente në Kuvend dhe institucionet profeisonale që të kyçen në këtë fazë dhe të ndihmojnë, edhe institucionet tjera profesionale jashtë Kuvendit dhe Qeverisë dhe personat tjerë që mirren me këtë problematikë, të kyçen pra dhe të ndihmojnë për përgatitjen sa më të shpejtë të një draftligji që do ta kishim pasë brenda muajit nëntor prapë në diskutim në Kuvend. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit zoti Shatri. Smilka Milosavleviq. Le të përgatitet Drita Statovci.

SMILJKA MILOSAVLJEVIQ:

Poštovano Predsedništvo, poštovane kolege poslanici. Mogu da kažem da prvi vizualni utisak koji se stiče kada čovek živi na ovoj teritoriji jeste da je uvidom u prostor i okolinu razmatranje ovog nacrta zakona u Skupštini prioritet osnovano. Što se samog zakona tiče, normalno je da je i zaštita sredine, zaštita vode i vazduha, zaštita zemljišta od otpadaka i zaštita biološke raznolikosti na našoj teritoriji sada u ovim uslovima prioritet. Što se

samog Zakona tiče, Zakon je u skladu sa evropskim standardima i odredjuje osnovne principe zaštite životne sredine u smislu ograničenja zagadjenja sredine, zatim raznošenja opasnih materija kao i lociranje opasnih materija, a u ostalom i kao normiranje po pitanju odgovornog korišćenje prirodnih resursa. Posebno je bitno da pri izradi Nacrta ovog zakona su korišćeni opšti standardi i načela za zaštitu životne sredine odnosno akta Medjunarodne konvencije i smernica Evropske zajednice.

Što se Koalicije "Povratak" tiče, ona nema nekih posebnih primedbi na Nacrt ovoga zakona osim par primedbi na pojedine članove, koje primedbe ćemo proslediti normalno funkcionalnim odborima i, obzirom da je razmatranje ovoga zakona sada u načelu, ja ne bih koristila skupštinsko vreme. Rekla sam da ćemo primedbe dostaviti funkcionalnim odborima odnosno Odboru za interese zajednica i Odboru za zaštitu sredine. Što se Koalicije "Povratak" tiče, smatramo da ovaj zakon u načelu možemo prihvatiti. Hvala.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Zonja Statovci, le të përgatitet Naim Maloku.

DRITA STATOVCI:

I nderuari kryetar dhe Kryesi, të nderuara kolege dhe kolegë. Falemnderit për fjalën e dhënë. Më duhet të them se është kënaqësi që tani dita-ditës kemi ligje dhe kemi korniza pra sipas të cilave punojmë dhe mund të them se në parim ligjin, Projektligjin në të vërtetë mbi mbrojtjen ambientale duhet ta pranojmë dhe ta mbështesim dhe po ashtu mendoj se i dedikohemi falënderimit për punën dhe mundin e dhënë për këtë ligj, por gjithashtu kërkoj që t'më ndieni se edhe pse nuk jam juriste megjithatë ka fusha në të cilat pak a shumë ndokush këtu prej nesh merret vesh, prandaj vetëm me qëllim që ky ligj të jetë sa më i mirë dhe sa më i plotë të japim sygjerime ose plotësime dhe në këtë drejtim edhe unë kam disa sygjerime.

Konkretisht, në faqën 3 të tekstit shqip, pa bërë krahasime me të tjera sepse posa pash që të bëjë krahasime humbi shumë kohë se nuk janë të njëjta, është punë e atyre që mirren me këtë të punojnë në akordimin e këtyre çështjeve, por e them se neni 2, paragrafet që kanë të bëjnë me lejen ambientale dhe me liçenca, është mirë që ta kenë një shtesë sa i përket kushteve dhe kritereve që përmenden te liçencimi dhe duhet të kemi edhe mendimin ose klauzulën në të cilën do të thuhej: "Ministria para se të lëshojë lejen ambientale ose liçencën më parë të ketë mendimin dhe pajtimin e institucioneve universitare shkencore profesionale dhe të ekspertëve të fushave përkatëse: arkeologë, etnologë, antropologë". Këtë e them se në shumicën e neneve të këtij projektligji parashihet mbrojtja ambientale më tepër në kuptimin e ekologjisë biologjike dhe zoologjike, flora dhe fauna dhe më pak në pjesën antropologjike ose antropologji ekologjike apo ekologji antropologjike. Prandaj, jam e mendimit se duhet të jenë të përfshira edhe këto pikëpamje në mënyrë Projektligji dhe më vonë Ligji të jetë më të efektshëm.

Po ashtu.gjithnjë te neni 2, kur vijmë te përkufizimet, në faqën 5, paragrafi 3, në faqën 5 pra, aty ku numërohet: "Vlerat e çmueshme të natyrës" në vazhdim të paragrafit pra, pa heqë asgjë por vetëm të shtojmë, të shtohet: "llojet e trashëgimisë kulturore, me vlera shkencore dhe turistike, të karakterit arkeologjik, etnografik ose të natyrës tjetër me elemente kulturore ekologjike". Do to thotë kjo të shtohet në paragrafin Mbi vlerat e çmueshme të natyrës.

Dhe, në faqën 26, pas nenit 37 ku parashihet Mbrojtja e diversitetit biologjik, është mirë të kemi një nen të veçantë në të cilin do të parashihet mbrojtja e diversitetit biologjik është mirë të kemi një nen të veçantë në të cilin do të parashihej mbrojtja antropologjike ose mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe formulimi përafërsisht duhet të jetë:

"Mbrojtja dhe përkujdesja ndaj trashëgimisë kulturore me vlera shkencore ose turistike përfshin:

a) Mbrojtjen e ambienteve të hapësirave me gjetje arkeologjike dhe të hapësirave ose ambienteve të përcaktuara si të tilla por që nuk i ka filluar gjurmimet;

b) Mbrojtjen e vendbanimeve ose të lagjeve të një vendbanimi të përcaktuar e të vlerësuar si të rëndësishëm dhe si trashëgimi kulturore, etnografike, arçitektonike ose vlerë tjetër kulturore;

c) Mbrojtjen e ambienteve ekologjike, antropologjike, etnografike të definuar si e mirë me vlera shkencore dhe atraktive turistike, dhe

d) Mbrojtjen në formë sondimi paraprak për të vërtetuar nëse një ambient mban vlera trashëgimore ose shkencore".

Ju falemnderit. Këtë vetëm në funksion të plotësimit të këtij Projektligji.

KRYESUESI:

Ju falemnderit zonja Stataovci. Zoti Naim Maloku, le të përgatitet zoti Esad Dauti.

NAIM MALOKU:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar ministra. Me vëmendje kam shfletuar dhe lexuar Projektligjin për mbrojtjen e ambientit të cilin e konsideroj si shumë të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për Kosovën duke marrë parasysh shkallën e shkatrrimeve në natyrë dhe ambient që i ka pësuar Kosova në të kaluarën. E përgëzoj ministrin, Ministrinë dhe Qeverinë për punën që e kanë bërë në hartimin e këtij ligji i cili është sot para nesh. Pajtohem me zotin Shatrin se ky ligj, ky projektligj do të pengojë në njëfarë mase jo fort të vogël por mjaft të madhe që Kosova të bëhet poligon i ardhjes së teknologjisë së vjetëruar dhe të dyshimtë sa i përket mbrojtjes së ambientit nga investitorët e huaj. E dijmë të gjithë se zakonisht shtetet e pazhvilluara dhe ato në tranzicion janë poligone shumë të përshtatshme për investitorët e huaj të cilët dëshirojnë që pjesët e teknologjive të vjetëruara apo të ndaluara në vendet e tyre t'i eksportojnë, pra në ato vende. Ne duhet ta paguajmë një çmim,shoqëria kosovare, ne gjenerata jonë jemi duke paguar çmimin e qasjes shumë të gabuar ndaj ambientit

ku kemi jetuar dhe ndaj natyrës dhe ju ftoj, të nderuar deputetë, që në këtë vendim, pra se a do të paguajmë një çmim edhe më të madh të mbizotërojë arsyeja e shëndoshë në mënyrë që të vendosim drejt që më në fund shoqëria kosovare, ne si Kosovë, të kemi një ligj i cili do të bëjë kthesë në qasjen tonë ndaj ambientit dhe natyrës.

Si kryetar i Komisionit parlamentar për planifikim hapësiror dhe ambient, dje së bashku me anëtarët e Komisionit kemi vizituar kompleksin e KEK-ut, Minierat sipërfaqësore Bardhi i Madh, Mirash, fshatin Dardhishtë, Termocentralet e "Kosovës A", Inkos-in dhe kemi parë në terren se çka do të thotë një qasje aq shkatërruese ndaj natyrës dhe ambientit që është bërë në të kaluarën. Ne e dijmë dhe jemi të vetëdijshëm se do të biejnë ndesh pra shumë me këtë ligj edhe dy gjigante të Kosovës – KEK-u, termocentralet por edhe në rend të parë Fabrika e Çimentos në Han të Elezit mirëpo mendoj dhe propozoj që ky ligj të aprovohet në parim dhe të shkojë në procedurë. Ligji ka kaluar edhe procedurën e debatit. Në të janë kyçë edhe të gjitha shoqatat joqeveritare të cilat merren me këtë problematikë, institutet e ndryshme, pra është një lepezë e gjerë e të gjithë atyre faktorëve që janë të interesuar për një ambient më të shëndoshë. Në emër pra edhe të grupit parlamentar të Aleancës e mbështesim pra në parim këtë ligj dhe propozojmë që të shkojë në procedurë të mëtejshme. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Falemnderit zoti Maloku. Zoti Esad Dauti. Le të përgatitet zoti Bogolub Milosavleviq.

ESAD DAUTI:

E nderuara Kryesi, kryetar, të nderuar ministra, të nderuar kolegë. Propozimi për aprovim i Projektligjit për mbrojtjen e mjedisit është vërtetë për t'u falënderuar. Unë

mendoj se ky propozim është edhe i vonuar, është dashur shumë më herët duke ditur gjendjen ekologjike në tërë territorin e Kosovës. Është i vonuar pse tani kemi kohën kur tani duhet të fillojnë investimet e për këto investime duhet të mendojmë fare mirë. Ky ligj të jetë pak me një plasticitet, kur them plasticitet dihet për çka mendoj se kemi nevojë për investime kurse deri më tani rrjedhat si kanë shkue në trevan kosovare ato janë rrjedha të paarsyeshme. Importimi i gjithë atyre pompave të benzinës që kanë hyrë në Kosovë, të gjitha pompat e përdorura, të dalura prej përdorimit sot i kemi në Kosovë. Koment aty nuk kemi. Është tragjedi për ne. Vërtetë ishim dje edhe pamë termoelektranat të cilat ne i dijmë edhe më herët, i dijmë efektet, pasojat kanë qenë të mëdha prej termoelektranave kur kanë punuar me kapacitet të plotë e lere më tani, aty vërtetuam se ujërat të cilat rrjejdhin i përdorur, nuk them unë ujërat e zeza por uji i përdorur nga industria rrjedh direkt në lumin e Sitnicës. Analizat që i kemi bërë tregojnë se Sitnica është lum thuaja i vdekur. Ato organizma që jetojnë janë organizma që kanë kërkesa të veçanta që na tregojnë se në çfarë gjendje është. Aty duhet të mirren masa. Ato masa mundet vetëm ligji me i pru. Është fakt se ky ligj ka të meta e ato të meta duhet t' i plotësojmë ne dhe ne jemi këtu që duhet t'i plotësojmë gjithësesi, të kontribuojmë secili me mundësitë e veta. Unë për veti do të mundohem që me shkrim t'i dorëzojë vërejtjet të cilat mendoj se janë të arsyeshme. Veçmas në këtë ligj mungon rregullativa për eko-sistemet artificiale. Kur flas për eko-sistemet artificiale mendoj për eko-sistemet urbane dhe ato rurale, aty duhet me ligj disa gjëra t'i kemi plotësisht të qarta. Nëse na mungon edukata ekologjike ligji duhet të hyjë në përdorim prandaj mendoj ato në ligj duhet të inkorporohen . Pajtohem me parafolësit e mij edhe me Shatrin, kolegun Malokun dhe tjerët që i plotësuan disa gjëra që janë të

nevojshme. Unë kisha kërkuar që ky ligj në parim të ecë, por intervenimet të bëhen dhe janë me interes për të gjithë neve, kështu që nuk ka çka të diskutojmë më tutje. Të kontribuojmë sipas mundësive, kush çka mundet edhe në komisione dhe jashtë komisioneve. Nuk është vetëm Komisioni i planifikimit hapësiror meritor vetëm për këtë por duhet të kyçen edhe komisionet tjera të cilat në një masë do të kontribuojnë për këtë që ky ligj sa më shpejt të vëhet në përdorim.Gjendja jonë është e mjerueshme. Pyjet tona shkuan krejt. Unë kam shkuar me një ekip prej Istogu në Pejë, në Deçan, në Shtërrpcë isha atje. Prerja është e pamëshirshme. Prandaj ligji duhet të bëhet. Jo vetëm ky ligj, parimisht duhet të gjitha ligjet t'i vëjmë në përdorim sa më shpejt. Përmirësimin, meqenëse është fillimi, është leht ta bëjmë, kurse ligjet tjera të cilat kanë kaluar të metat neve duhet me amendamente t'i përmirësojmë. Unë kaq. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit profesor. Bogolub, pastaj le të bëhet gati Lulzim Zeneli, ju lutem të kemi konsideratë...

BOGOLUB MILOŠEVIĆ:

Poštovano Predsedništvo, poštovane kolege, poštovani gospodine ministre. Prvo, da ispravim grešku. Gospodja Smiljka je Milosavljević a ja sam Milošević. Zakon, zapravo Predlog zakona je dobar. Ja samo strahaujem da će se teško sprovoditi jer znam naš mentalitet, znam naše navike i morali bi smo mnogo da radimo i na edukaciji, da obrazujemo ljude da znaju da se ekološki ponašaju.

Sad bi se osvrnuo samo na jedan član. Član 33. koji govori o zaštiti zemljišta. Ima dva stava i tu se ne pominje degradacija poljoprivrednog zemljišta, a svedoci smo da se svakodnevno na poljoprivrednom zemljištu i to na onom zemljištu najkvalitetnijem gradi i to zemljište se uništava urbanizacijom. Mislim da bi trebalo da se razmišlja da se u ovom članu ugradi stav gde bi svako onaj ko hoće da gradi na kvalitetnom poljoprivrednom zemljištu treba da plati stostruku vrednost tog zemljišta. Hvala.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Zoti Lulëzim Zeneli, pastaj Tomë Hajdaraj.

LULËZIM ZENELI:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar deputetë, Qeveri e respektuar. Çdo ligj e ka rëndësinë e vet, por unë do të thoja se nxjerrja e Ligjit për mbrojtjene e ambientit ka rëndësi të veçantë se në vetë faktin se në një mënyrë apo tjetër përcakton qartë edhe perspektivën e vendit. Kosova deri më tash nuk e ka pasur një ligj të tillë dhe i ka munguar, një ligj tillë i cili do ta mbronte ambientin gjegjësisht do t'i mbronte resurset e saja natyrore. Ambienti në Kosovë, gjegjësisht resurset e saja me dekada e veçanërisht në dekadën e fundit kanë pësuar një dhunim të vrazhdët e kjo dihet si pasojë e okupimit por mungesë edhe të ligjit i cili do ta mbronte.

Mendoj se me nxjerrjen e këtij ligji do të përmbyllet ky kapitull, por ligjin e kam lexuar me vëmendje dhe kujtoj se është koha që tash të kyçen profesionistët e lëmive përkatëse dhe ata ta thonë fjalën e vet. Veçanti e këtij ligji është se ky ligj është harmonizuar me të gjitha normat dhe parimet ndërkombëtare dhe konventat për mbrojtjen e ambientit. Por, të mos harrojmë se Kosova ka veçantinë e vet, i ka specifikat e veta. Mbi të gjitha unë kujtoj dhe çka do t'i referohem këtë herë kapitullit të ujërave, ajo çka është esenciale për Kosovën tash për tash dhe kujtoj se në këtë ligj mungon një qasje konkrete do të thoja direkte e cila do të siguronte mbrojtjen gjegjësisht do të ndalonte ndotjen e ujërave. Unë do ta citoja vetëm një konstatim të Organizatës Botërore të Shëndetësisë – se t'u sigurosh

banorëve ujë higjenik dhe stacion adekuat të ujërave hedhurinë ua ke siguruar 60% të standardit jetësor. Kjo është shumë me rëndësi për qytetarët e Kosovës dhe në vçanti për ne po them kur ne jemi në një fazë kur duhet të nxjerrim ligje dhe këto ligje duhet t'u përshtaten rrethanave tona. Çka është tjetra me rëndësi e këtij ligji është se duhet të ceken edhe nevojat për investime në këto fusha, jo vetëm fushën e kapitullit të ujërave por edhe në fushat tjera dhe unë nuk do të zgjerohem shumë por të gjitha ato vërejtje unë do t'i paraqes nen për nen me shkrim, dhe kujtoj se do ta begatojnë këtë ligj. Jam që ky ligj në parim do të ecë mirëpo ky ligj do të plotësohet për shkak të nevojës adekuate dhe nevojës e cila nevojitet që Kosova të ketë sa më parë këtë ligj. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Zoti Tomë Hajdaraj, pastaj zoti Berat Luzha le të përgatitet.

TOMË HAJDARAJ:

Ju falemnderit zoti kryetar, të nderuar deputetë, ministra të respektuar. Sikur edhe ligjet tjera edhe ky ligj me vetë faktin që ka ardhur në procedurë është domosdo e kohës që tha edhe profesor Dauti pak e vonuar por më mirë vonë se kurrë, ndërsa nga ekspozeu i ministrit kam shkëputur nja dy fjali – Kosova vendi më i ndotur në Evropë dhe shkallën e ndotjes së perimeve, domethënë 15 fish mbi të lejuarën. Unë mendoj se kjo e dyta duhet ndoshta pak të zbutet e mos të them nuk qëndron sepse e deshëm apo s'e deshëm e kemi borxh edhe për prodhuesit tanë dhe e dijmë mirëfilli se në cilat ambiente prodhohen perimet në Kosovë. Prodhohen në Rrafshin e Dukagjinit që për mendimin tim ambienti nuk është i ndotur në atë masë, të kemi kujdes pak po them sepse fjala e thënë këtu merr opinionin dhe mund të vijmë në kundërshtim ndoshta edhe me rrjedhat e tutjeshme.

Sa i përket Ligjit, e kam lexuar me vëmendje sa kam mund dhe ministri tha se kemi pas të bëjmë edhe me bashkëpunimin me Ministrinë e bujqësisë e cila, sipas meje, është shumë pak këtu e kyçur, bile sa është e shkruar, nuk e dij ndoshta marrëveshje gojore ka pasur por është e shkruar shumë pak. Shembull konkret e kemi te Agjencioni i Kosovës

për mbrojtjen e ambientit ku janë paraparë institutet qoftë ai hidrometeorologjik apo edhe ai i mbrojtjes së natyrës, në realitet të ministrisë, dhe punëve administrtive profesionale. Duhet të parashihet që në kontinuitet bashkëpunimi i Ministrisë së ambientit me Ministrinë e bujqësisë, sikur që tha edhe zoti Zeneli për Kosovën i ka splecifikat e veta për bashkëpunim të ndërsjellë dhe më të ngushtë.

Në vazhdim është aksidenti ekologjik, domethënë neni 2, pika 2. Kisha me ju lutur që aty të riformulohet një fjalë dhe bile kemi biseduar edhe me njerëzit ekspertë të lëmisë së ekologjisë dhe të ambientit dhe ku është "aksident" të ndërrohet dhe ta gjejmë një term më adekuat, qoftë "rrezik", qoftë edhe fjali tjetër. Sepse, nëse ndalemi vetëm në "aksident" atëherë domethënë e minimizojmë çështjen vetëm në një pjesë, në një aral ose në disa metra katrorë e mos të them edhe më pak.

Gjithashtu duke u nisur prej licencave kemi ardhur deri te rreziku për ambientin dhe unë kam shtuar një fjali dhe mendoj se është e qëndrueshme se duhet të parashihen edhe fatkeqësitë elementare: reshjet e breshërit, rreziqet nga zjarret, terrmetet, vërshimet, temperaturat e larta, temperaturat e ulëta të cilat krahas shkatrrimeve në masë mund të na shkaktojnë edhe prishje të ambientit posaçërisht kur është fjala për kulturat bujqësore të cilat dëmtohen dhe me rastin e rregullimit të temperaturës aty mund të shkaktohen edhe sëmundje të ndryshme, domethënë prishje të ambientit. Kemi në Parimet themelore të ambientit, është parimi i përgjegjësisë subsidiare. Është thënë aty që të mos njohjes së ndotësit Qeveria e Kosovës e bartë përgjegjësisë, ose në rast të ndotjes nga shteti fqinj përgjegjësinë e bartë Qeveria. Unë mendoj, këtu bile me zotin Naim dhe me zotin kryetar të Parlamentit e kemi pasur një eksperiment edhe në Amerikë ku kemi pasë probleme bukur shumë të mëdha në rregullimin e atyre çështjeve, kemi thirrur edhe ndërkombëtarët aty me ndërmjetësues e tjera, e tjera. Duhet të parashihet këtu patjetër që... Për shembull kemi rastin e lumenjve të cilët kalojnë disa shtete, aty duhet të rregullohen me dokumenta përkatës me karakter ndërkombëtar. Kapitulli i veçantë është - Dokumentet për mbrojtjen e ambientit. Është - Strategjia e Kosovës për mbrojtjen e ambientit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të ambientit. Kisha dëshiruar dhe mendoj se është e qëndrueshme që vetë fjala strategji e ka një kuptim bukur të gjerë, andaj le të rishqyrtohet ky kapitull edhe një

herë meqenëse ne të hënën e kemi në rend të ditës si Komision parlamentar për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural të Kosovës.

Në parim mbështes këtë ligj dhe mbështes edhe parafolësit të cilët thanë se duhet të ndryshohen disa, mos të them, një masë e konsiderueshme e këtij vëllimi të ligjit në mënyrë që të jetë edhe kompatibil por edhe i qëndrueshëm dhe afatgjatë sepse ligji kur të aprovohet, në aplikim, kisha dëshiruar, që të jetë i suksesshëm. Falemnderit.

KRYESUESI:

Para se t'ua jep mikrofonin deputetëve tjerë. E drejtë demokratike është me shfrytëzuar e me folë, por demokratike është edhe me abstenuar në qoftë se nuk kemi diçka të re dhe mund të jepen me shkrim shumë çështje, sepse po humbet shumë kohë, prandaj mund të jepen në mënyrë amendamentesh dhe të jetë kontribut shumë më i rëndësishëm se këto. Fjalën e ka Berat Luzha. Vazhdimisht po motivohen diskutues të rinj prej fjalëve, ju lutem që ata e kanë studuar, dhe ata që në parim kanë thënë diçka e ato tjerët në parim me shkrim të prezentohen.

BERAT LUZHA:

Të nderuar kolegë. Unë i bashkëngjitem shqetësimit dhe brengosjes së parafolësve të mij për ndotjen dhe për shkatërrimin e ambientit në Kosovë dhe nxjerrja e një ligji për ambientin është mëse e domosdoshme dhe Kosovës i ka munguar një ligj i tillë i cili do ta rregullonte normativën ligjore për mbrojtjen e ambientit, për mbrojtjen nga hedhurinat, nga materiali i ndryshëm i rrezikshëm qoftë edhe ai radioaktiv siç ishte rasti në Mitrovicë. Ky propozimligj ka parametrat normative për mbroljtjen dhe rehabilitimin e ambientit të standardeve ndërkombëtare. Pastaj, është problem akut dhe aktual propozimlilgji dhe shpresojmë që do të bëhet që të kontrollohen dhe të inspektohen edhe mallrat që vijnë nga amporti sidomos ato ushqimore të cilat nuk kanë ndonjë kontroll dhe janë mjaft të dyshimta përnga cilësia. Megjithatë, mendojmë se me këtë projektligj është paraparë formimi i një strukture të tepruar për kryerjen e punëve administrative,

profesionale, shkencore e tjerë në fushën e mbrojtjes së ambientit siç janë: Agjencioni për mbrojtjen e ambientit, enti apo instituti për mbrojtjen e natyrës dhe të ambientit, fondi për ambient, bordi mbikëqyrës për mbrojtjen e natyrës dhe inspektorati i ambientit, të gjitha këto të nivelit qendror, domethënë në kuadër të ministrisë, kurse nuk paraqitet asnjë instancë e mbrojtjes së ambientit në nivelin lokal komunal, pos inspektorëve komunalë për ambient. Kur merret parasysh se me problematikë të përafërt merren edhe Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Bujqësisë dhe e Pylltarisë, Enti Higjenik i Kosovës e tjerë, atëherë mund të krijohen paralelizma dhe duplifikime të kompetencave por edhe padefinim i kompetencave. Andaj, duhet që kjo strukturë e planifikuar me këtë propozimligj për organizimin e Ministrisë për Mbrojtjen e Ambientit dhe Planifikimit Hapësiror të thjeshtëzohet në mënyrë që ajo të bëhet më efikase dhe që mos ta ngarkojë buxhetin me administratë dhe shërbime të tepruara siç jemi mësuar të krijojmë deri tash.

Propozimligji pastaj si tërësi përmban dispozita të paqarta sa duhet, të panevojshme dhe konfuze të cilat nuk sqarojnë sa e si duhet sidomos kompetencat dhe autoritetin e ekzekutivit dhe të ligjdhënësit si dhe kompetenca në nivelin qendror dhe nivelin lokal. Propozimligji ka të ngjarë të komplikojë për momentin edhe realizimin e investimeve të mundshme me procedurën për marrjen e pëlqimit ambiental, të lejes ekologjike dhe të autorizimit ambiental.Pse të merren 3 dokumente të ngjashme me rastin e investimit dhe të ndërtimit të ndonjë objekti ekonomik në vend se të merret një me përmbajtje të inkorporuar. Vlerësimet ambientale dhe sidomos procedura e tyre duhet të thjeshtëzohen dhe unifikohen. Në të kundërtën, ligji do të vështirësonte tej mase jo vetëm procedurën por edhe do t'i ngarkonte me shpenzime shtesë afaristët që mund të jenë të gatshëm të investojnë. Ligji i jep pushtet të tepruar ministrit i cili ngarkohet pa nevojë me një gamër kompetencash që nuk i duhen fare. Prandaj, kudo që përmendet fjala "ministër" propozoj të zëvendësohet me fjalën "Ministria". Raportet në mes Ministrisë dhe ministrit duhet të rregullohen me rregullore interne të veçantë.

Askund nuk parashihet çështja e ripyllzimit që është një nga brengat, një nga preokupimet e rëndësishme për mbrojtjen e ambientit dhe mendoj se kjo çështje duhet të hyjë në një nen të veçantë. Duke marrë parasysh se Kosova nuk ka ligj ambiental,

kurse gjendja në këtë lëmi është përkeqësuar tepër shumë, grupi parlamentar i PDK-ës e mbështet në parim miratimin e tij me rekomandim që Propozimligji të rregullohet dhe në të të përfshihen të gjitha vërejtjet e dhëna. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ibush Januzi. Le të përgatitet Sylejman Çerkezi.

IBUSH JANUZI:

Zoti kryetar, deputetë të nderuar dhe ministra të respektuar. U tha shumë, andaj do të përpiqem me qenë shumë i shkurt në fjalën time. Projektligji mbi mbrojtjen e ambientit është i një rëndësie të veçantë për të cilin ne kemi nevojë në afat sa më të shkurtër të hyjë në fuqi për zbatim por paraprakisht mendoj se duhet të jetë i zbatueshëm në praktikë. Andaj atë se çka u tha më herët e mbështes e në veçanti e mbështes diskutimin e kolegut Shatri se esenca është m'u aty. Do t'i ceku vetëm disa çështje për të cilat mendoj se ka nevojë ky projektligj t'i përmban. Neni 6, pika c, pika f, pika h duhet të sqarohen dhe të kompletohen më mirë se që janë tani. Neni 8, pika 2 – programet e nxjerrë nga komuna paraprakisht duhet të njoftohet ministria përkatëse e pastaj të aplikohen në komuna. Mendoj se duhet të jetë një formulim i tillë. Neni 12, pika 1 nën 2, duhet të precizohet se gjatë transportit të mjeteve të cilat në rast aksidencial mund të shkaktojnë shkallë të lartë të rrezikshmërisë. Mjejti transportues që bën transportin duhet të ketë përcjellje të posaçme për mos me ardhë deri te kjo. Neni 12 – Masat e mbrojtjes dhe të rehabilitimit. Të precizohet se varësisht prej shkallës së dëmtimit të caktohet edhe afati i rehabilitimit e jo siç është paraparë në Projektligj. Neni 23, pika 3 nën a) të përpilohet më mirë, është e paqartë në Projekgligj. Neni 24, pika 3, në fund të pasusit të sqarohet. Pika 6 e po të njëjtit ligj, afati i dhënies së pëlqimit ambiental apo e refuzimit të jetë më i shkurtër sesa që është paraparë me Projektligj siç u tha edhe më herët. Këto janë çështje të cilat e pengojnë realizimin e shumë projekteve dhe investimeve të tjera. Neni 25, pika 2, të analizohet se në cilën fazë është më mirë të jipet leja ekologjike apo ashtu siç është paraparë në projektligj dhe në fund neni 34, atë që e tha edhe profesor Dauti, fatkeqësisht

ka mjete dhe stabilimente të vjetruara që vijnë nga jashtë andaj pika 1 Pajisjet dhe stabilimentet të cilat shfrytëzohen duhet të kenë komplet dokumentacionin komplet si dhe atestet për përdorim të mëtutjeshëm. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit zoti Jonuzi. E ka fjalën Sylejman Çerkezi. Le të bëhet gati Exhlale Salihu.

SYLEJMAN ÇERKEZI:

Zonja dhe zotërinjë e di që ndoshta jemi lodhur por e kam për obligim ndoshta të dalë e të ju marr një minut apo një minutë e gjysmë. U fol për rëndësinë dhe vlerat e këtij projektligji. Unë do të thoja se në çdo projektligj ka nene por duhet të ketë edhe nene shtesë në të. Mendoj se në dy gjigantet që janë në komunën e Kastriotit e nuk do të përjashtoj edhe komunën e Mitrovicës, mendoj se është koha për Ministrinë që në veçanti këto dy komuna të zënë një vend të veçantë sa i përket çështjes së ambientit. Nuk është e mjaftueshme të dëgjohet ose të shifet në ekranet televizive siç është ajo kur përjetohet. Ju zotërinjt që e keni vizituar këtë komunë ndoshta e keni vizituar pas orës 12. Ndoshta edhe për kryetarin do të jetë risi. Në komunën e Kastriotit dielli nuk lind atëherë kur lind në Kosovë. Në komunën e Kastriotit nganjëherë dielli lind në orën 10 e nganjëherë nuk lind fare gjatë gjithë ditës dhe për këtë mendoj se pikërisht në këtë projektligj komuna e Kastriotit dhe komuna e Mitrovicës kur kemi të bëjmë për njeriun mendoj se duhet të kenë një status të veçantë aq më tepër kur do të na vijnë ligjet e privatizimit mund edhe këto të kenë ofertat e tyre dhe absolutisht nuk do t'iu bëjë përshtypje të tjerëve për atë që lënë pas ose pasojat që vijnë nga ato por iu bëjnë përshtypje vetëm përfitimet ose profitet që mund t'i nxjerrin nga këto gjigante. Për këtë arsye detyrë jona parësore është që të mendojmë dhe pikërisht me ligj t'i mbrojmë këto dy komuna në veçanti sepse nuk janë të një rëndësie të veçantë në një komunë ku nuk mund të ketë parqe ose në komunë të Kastriotit ose në Mitrovicë ku të rrezikohen jetrat e njerëzve. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Exhlale Salihu. Le të përgatitet Hasan Meta.

EXHLALE SALIHU:

Të nderuar kolegë deputetë. Unë do të ndërlidhem me diskutimin dhe plotësimin e kolegës sime zonjës Statovci me vërejtjet e së cilës pajtohem plotësisht duke shtuar edhe diçka shkurt për t'iu përmbajtur kohës. Më falni, e paskëm harruar ligjin.
Kjo ka të bëjë me kapitullin e 3, neni 9 paragrafi 2 në faqën 12, gjë e cila lidhet me kapitullin l, neni 4, paragrafi 1e faqe 7. Këtu shkruan: Përcaktimi i regjimit të posaçëm në ruajtjen dhe shfrytëzimit e zonave të mbrojtura të natyrës, të vendburimeve të ujit, burimeve termike dhe minerale, të pyjeve, të tokës, hapësirave të gjelbruara publike, rajoneve rekreative dhe banjave. Unë kisha shtuar: edhe lokaliteteve arkeologjike në veçanti. Këtu fjalën e kam jo vetëm për lokalitete të verifikuara por edhe për zbullime të rastit në prona shoqërore, meqë ato në prona private kërkojnë një trajtim të veçantë të cilat në fakt janë mjaft senzacionale dhe në të mirë të historisë sonë të lashtë. Në këtë rast nuk flas vetëm nga aspekti dhe obligimi im personal por edhe nga aspekti edhe nga aspekti i normave ndërkombëtare.

Ndërkaq, ne kemi një përvojë të hidhur nga e kaluara të cilën gjë do ta ilustrojë me një shembull konkret. Fjala është për lokalitetin në fushën e Pejës ku me rastin e ndërtimit të Fabrikës së baterive industriale, megjithëse dolën në dritë objektet e palevizshme dhe të lëvizshme arkeologjike madje të veçanta në Kosovë, megjithë intervenimin dhe angazhimin e madh të ministrit të atëhershëm të kulturës profesor Ymer Jakës dhe angazhimit tim personal. Në kohën e tanishme të hulumtimeve të vrullshme arkeologjike një rast i tillë mund të na delë prapë dhe çka të bëjmë nëse këtë nuk e kemi të paraparë me ligj jo vetëm nga Ministria e Kulturës mirëpo nuk e kemi paraparë me ligj as nga kjo Ministri. Se sa rëndësi u jepet këtyre zbulimeve dhe mbrojtjes së tyre që me siguri është paraparë me ligj, do të ceku 2-3 shembuj. Në Lubjanë, gjatë ndërtimit të një rruge, tash e 3 vjet janë ndërpre punimet do të thotë në një sektor meqë ka dalë një lokalitet

arkeologjik ku po bëhen hulumtime dhe derisa të kryhen ato dhe të vëhet lokaliteti në mbrojtje të institucioneve përkatëse ndërtimi i saj mbetet në atë gjendje madje edhe t'i ndërrohet kahja e ndërtimit. Ndërsa, në Ohër, lokacioni i shtëpisë së mallrave është ndërrue vetëm për shkak të një zbulimi të një rasti arkeologjik. Në vende të tjera kemi edhe përvoja tjera, për shembull në Romë, gjatë ndërtimit para se të ndërtohet objekti i tanishëm objekti i mëparshëm është mbrojtur dhe pa u dëmtuar fare është shndërruar në një muze të tipit natyror. Ka edhe shembuj tjerë, unë nuk do t'ju lodhi. Mirëpo, më falni unë isha pak e lodhur, desha me iu përmbajt kryetarit dhe u nguta me marrë këtë dhe u mbusha pak frymë. Besoj se e gjithë kjo nëse merret parasysh do t'i kontribuojë mjaft ruajtjes së trashëgimisë sonë të pasur. Po e theksoj edhe një herë se gjetjet arkeologjike i takojnë ambientit meqë ato gjenden nën tokë, zakonisht nëntokë dhe mund të jenë shumë senzacionale dhe të dalin pa hulumtime arkeologjike, do të thotë na dalin ad hoc dhe atëherë çka të bëjm, do të thotë të ndërtojmë objekte, duhet shkatruar ato apo mos t'i shkatrrojmë dhe ta ndërtojmë objektin në një lokal tjetër. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Hasan Meta, le të bëhet gati Gojko Saviq.

HASAN META:

Zoti kryetar, e nderuara Kryesi, zonja dhe zotërinjë deputetë, zotëri nga ministri të ndryshme. Unë e përgëzoj Ministrinë për Ambient në paraqitjen e këtij projektligji dhe natyrisht për ne është hera e parë të kemi kësi lloj projektligjesh. Ka vërejtje të arsyeshme natyrisht nga lëmitë e ndryshme por nëse e kemi parasysh gjendjen ekzistuese në Kosovë, çka pajtohemi të gjithë dhe e dha arsyetimin zoti ministër, ne duhet të bëjmë çmos si deputetë por edhe të gjitha ministritë tjera që t'i akordojnë në mes veti interesat e Kosovës sipas veprimtarive të ndryshme zhvillimore sepse ne në të ardhmen na pret Kosova e banuar shumë e vogël me këtë sipërfaqa që e ka dhe mund të themi se Kosova në të ardhmen e afërt Kosova do të jetë një qytet dhe për zhvillimin e shëndetshëm të popullatës duhet të marrim masa preventive se çdo gjë që zhvillohet në Kosovë, çdo

veprimtari ta ketë për bazë Ligjin për ambientin e natyrisht edhe ligjin hapësiror që do të vijë më vonë. Jemi të detyruar që për gjeneratat e ardhshme të mendojmë shëndosh dhe në parim unë e mbështes këtë projektligj për ambientin dhe i lus të gjithë ata që merren me veprimtari të ndryshme që me mundësitë e veta ta begatojnë këtë ligj por ky ligj duhet të jetë rigoroz dhe decidiv në mënyrë që çdo gjë që bëhet në Kosovë ta ketë për bazë këtë ligj. Ju lus të gjithëve që të jeni konstruktivë në ato propozime që do t'i merrni. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit, zoti Meta. Gojko Saviq, pastaj zoti Fadil Kryeziu le të bëhet gati.

GOJKO SAVIĆ:

Poštovani predsedavajući, poštovani članovi Parlamenta. Ja ću vrlo kratko, ja želim da izrazim zadovoljstvo. Evo imamo recimo u ovom trenutku na dnevnom redu jedan zakon, Zakon o zaštiti životne sredine gde svi zaista delimo zajedničko mišljenje da smo ugroženi i svi razmišljamo na isti način. Čak mislim da su diskusije toliko konstruktivne i razmišljanja oko toga da o ovom zakonu razmišljamo mnogo više nego o zakonu o ljudskim pravima, to u ovom trenutku. E sad dolazi moja zloupotreba, ja hoću ovaj, što sam rekao, da kažem da je par poslanika i pored konstruktivnih diskusija umetne ponešto i političkog i ako bar ovaj zakon, Nacrt zakona o zaštiti životne sredine bar nema tih elemenata. Ali, ovaj, ja sam zaista protiv toga i kritike upućujem i sebi što sam to zloupotrebio i onima koji to zloupotrebljavaju navodno da je krivica znači prethodnih vlasti unazad desetak godina i tako dalje što se ovo dešavavalo i poruka i čestitka onima koji zaista na neki način konstruktivno diskutuju poput mog kolege Esad Dautija koji je posetio, kaže sam, odredjene objekte i u kakvom se sada stanju nalaze rećeno benzinskim pumpama da na rastojanju od 38 kilometara izmedju Prištine i Uroševca imao 32 benzinske pumpe. Nekada smo tu navikli da gledamo suncokret, sada osim pumpi i novih kuća nema ničega. Kosovo Polje – Priština je već spojeno i tako dalje. Znači, sve se to dogadjalo u zadnje 3 godine. A opet kritika i nekima koji, ili ja ne znam, možda

prevodioci to nama čine – promocija nekih novih opština koje meni nisu poznate. Zaista, nisu poznate i mi se pitamo o kojim opštinama je reč i možemo da nagadjamo prema onome o ćemu se priča o kom se mestu na Kosovu odnosno na kosmetu govori. Hvala vam. Samo toliko.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Fadil Kryeziu, le të bëhet gati Ramadan Kelmendi.

FADIL KRYEZIU:

Është ineresant, i nderuari kryetar, Kryesi, zoti minisër, të nderuar deputetë, ndonjëherë ne këtu parashtrojmë edhe deformimet tona profesionale edhe kur merremi me pedagogji ose pedagog dhe japim sygjerimet të tilla se si e çka... Të ju them të drejtën unë kam dashur që në parim të diskutoj më tepër për Ligjin mbi mbrojtjen e ambientit, mirëpo duke përcjell të gjithë kolegët e mij dhe zotin ministër dhe kolegët deputetë në të vërtetë vij në dilemë a është Kosova me ambient të shkatërruar apo duam Kosovën ta bëjmë një rezervat domethënë një ambient vërtetë të mbrojtur në mënyrë strikte. Sidoqoftë do të doja që mos të hapim shumë shqetësime, megjithatë duhet të angazhohemi në drejtim të ndërtimit të një ambienti të shëndoshë për njeriun tonë. Mirëpo, duke përcjellur me vëmendje Ligjin mbi ambientin kam vërejtjet e mia që ky ligj pa planifikim hapësiror, kam përshtypjen, do të jetë shumë i mangët. Në anën tjetër mendoj se kompetencat janë shumë të koncetruara në Ministri përkatësisht në ministër si është çështja e lejeve të ndryshme, akreditimeve, liçencimeve, vlerësimeve e tjera, e tjera. Shtroj çështjen ose pyetjen – ku janë komunat ose organet lokale në këtë rast dhe mund të them se do të ketë keqpërdorime nga më të ndryshmet sepse njerëzit edhe janë të prirur që për një leje ose për një liçencim të ndjekin rrugë të ndryshme, të vijnë deri te ato edhe kur vërtetë dëmtojnë edhe ambientin. Pastaj, shtrohet dilema, u shtru çështja e implementimit të ligjit, pra ministria, agjencioni, pastaj bordi, mandej çështja e sanimit të pasojave të shfrytëzimit të resurseve të ndryshme natyrore e të tjera, u shtru çështja e edukimit të popullatës e ku dij unë, prandaj hapen dilema. Nëse më pyetni a je për Ligjin do të thosha

po, por mund të më shtroni edhe pyetjen a je kundër ligjit gjithashtu do të thosha po. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Ramadan Kelmendi. Shpresoj Ramadan kësaj radhe do të jeshë i shkurt e jo si herën e kaluar.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë dhe ministra. Unë parimisht kam sygjerimet e përgjithshme dhe sygjerimet konkrete në tekstin. Vlerësoj dhe çmoj se grupi punues ka bërë shumë mirë si ashtu edhe Ministria që sot ka vënë në shqyrtim këtë projektligj. Nga vërejtjet parimore do të ishte kjo: Edhe ky propozimligj na vjen në shqyrtim me formulime të gjata të dispsozitave ligjore të cilat në disa raste vijnë ndesh njëra me tjetrën dhe si të tilla janë të paqëndrueshme dhe në kuptimin e zbatimit praktik. Vërejtjet konkrete. Po heqi dorë nga një pjesë formale. Pasi që me dispozitën e nenit 1 të këtij propozimligji përcaktohet mbrojtja e ambientit nga subjektet juridike dhe fizike edhe me qëllim të sigurimit të ambientit të shëndoshë në masat ndëshkuese duhet precizuar shkalla dhe lloji i masave për shkelësit e ndotjes së ambientit dhe në veçanti ndotja përmes bërllogut të grumbulluar. 2 – ndotja me tym dhe gazna të tjerë nga industria dhe 3 – ndotja nga lëshuarjet e ujërave kimikë në lumin Ibër dhe Sitnicë në veçanti. Ky propozimligj nuk jep zgjidhje për dëmet që shkaktojnë depot e bërllogeve në qytete dhe lokalitete përreth. 2 - dëmet që shkaktojnë komplekset industriale në procesin e amortizimit dhe të pasivitetit dhe në veçanti të "Trepçës" dhe aktiviteti i Obiliqit për popullatën me rrethinë në ndotjen e lumit Sitnicë. Dëmet që shkaktojnë institucionet komunale të qyteteve me rastin e grumbullimit të mbeturinave dhe të cilat djegen pranë shtëpive tona. 3. Me këtë propozimligj nuk është përcaktuar mbrojtja e ambientit nga grumbullimi i automjeteve të vjetra, nga aksidentet në komunikacion m'u në tokat më pjellore dhe pranë shtëpive tona. Vlerësoj se duhet të përcaktohen zonat në mënyrë shprehimore ku ndalohet ndërtimi privat dhe shtetëror i ndërtimeve tjera me qëllim të

mbrojtjes së resurseve natyrore siç përcakton ky propozimligj duke e lidhur këtë me lejen e ambientit natyror në veçanti me tokën pjellore. Me këtë propozimligj ka qenë dashur të caktohen disa zona industriale të shtuara të mbrojtura nga ambienti siç është Mitrovica dhe Obiliqi me rrethinë ngase aty në mënyrë permanente në kohë të pandërprerë një kohë të gjatë janë grumbulluar mbeturinat e rrezikshme industriale dhe ndotja e ambientit. Në këtë propozimligj nuk janë të qarta kompetencat e Qeverisë, të ministrisë dhe të komunave për mbrojtjen e ambientit dhe në veçanti këtu do të shtrojë një pyetje – a mund komuna duke u bazuar në rregulloren 2000/45 për shembull të themelojë ent për mbrojtjen e ambientit apo ent hidrometeorologjik e të ngjashme diçka. Me këtë propozimligj nuk janë përcaktuar materiet e rrezikshme të cilat duhet ndaluar në qarkullim dhe në kontakt me botën e gjallë njerëzore, shtazore e tjera e tjera, cilat janë materiet të cilat importohen dhe nuk duhet të importohen, kultivohen dhe nuk duhet të kultivohen, përpunohen dhe nuk duhet të përpunohen dhe në veçanti me këtë propozimligj duhet të përcaktohet ripopullzimi e sipërfaqeve të erroduara, të degraduara dhe të pyjeve të prera, nuk dua të elaboroj më tepër, të ruhet ambienti publik nga duhanxhinjtë dhe në veçanti shkolla, autobusi e të tjera dhe të mbrohen qytetarët të cilët kanë pësuar nga ambientet e ndotura sidomos toka, shtëpitë, banesat dhe qytetarët e Mitrovicës, të Obliqiti e të tjera. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Sa e rëndësishme ishte problematika që e trajton ky projektligj tregon edhe numri i diskutantëve pjesëmarrës në këtë debat. 17 deputetë ishin me kontributet e tyre të çmuara. Unë do të doja ta përfundoj me një sygjerim – lutje të gjithë deputetëve dhe komisioneve përkatëse që të mos prishet ekuilibri në mes të tre parametrave kryesorë që e caktojnë jetën: zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik; e drejta e njeriut dhe e drejta për ambient të pastër. Në emër të saj, ju lus të votojmë. Kush është për aprovim në pariam të shqyrtimit të Projektligjit për mjedisin?

A ka ndonjë deputet që ka mendim të kundërt?
A abstenon ndokush?

Zoti Fatmir nuk mundeni dy herë me votuar edhe kundër edhe me abstenu! Vetëm një herë keni drejtë me votu. Ju falemnderit. Nganjëherë kemi nevojë edhe për relaksim. T'ju informoj për rezultatin: 88 deputetë kanë votuar pro, kundër 2 sepse i pavlefshëm vota e shokut që ia përmenda emrin, abstenuan 2.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For **88**

Kundër – Protiv – Against..... **02**

Abstenuan – Uzdržanih – Abstaned..... **02**

Pra, konsiderojmë që Projektligji shkon në procedurë të mëtejshme.

Dhe pika përfundimtare e rendit të ditës është – **PYETJET E DEPUTETËVE.**

Asnjë pyetje nuk është bërë për këtë seancë konform rregulores. Ju lutem ata që janë të interesuar, për mbledhjen e ardhshme le të bëjnë pyetje.

Ju falemnderit për pjesëmarrje në mbledhje.

MBLEDHJA MORI FUND NË ORËN 13 35.